



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Shkenca Politiko-Administrative”
i
Institucionit të Arsimit të Lartë
“Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Elda Zotaj
2. Dr. Fatri Morina

Tetor /2022

Për Programin e studimit Bsc në Shkenca Politiko – Administrative

Nr.		
1	IAL aplikues:	Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Shkenca Politiko – Administrative”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 8981 prot., dt.27.12.2005
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr.383, dt.28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr.82, datë 05.10.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite/ 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE/ 8 PAK v.a. 2021-2022 9 PAE/ 9 PAK v.a. 2020-2021 9 PAE/ 9 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	0 Studentë v.a. 2021-2022 7 Studentë v.a. 2020-2021 10 Studentë v.a. 2019-2020
19	Komente / të tjera:	-


TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politiko – Administrative” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore në Universitetin Privat “Albanian University”. Programi i studimit është licencuar në vitin 2005, nëpërmjet shkresës së MASH Nr. 8981 prot., datë 27.12.2005 “Mbi hapjen e fakulteteve të reja në Shkollën e lartë universitare jopublike “Ufo Dental””.

Programi i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik dhe është i akredituar nëpërmjet Vendimit të Bordit të Akreditimit, Nr. 82, datë 05.10.2019 “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, të Universitetit Privat “Albanian University””, me një kohëzgjatje të vlefshmërisë së akreditimit prej 3 vite akademike, deri më 30.09.2022.

Programi i studimit realizohet me 180 kredite ECTS, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademik (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor në “Shkenca Politiko – Administrative”.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr.27, datë 20.05.2022, në përputhje me dispozitat ligjore të MAS dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universiteti Privat "Albanian University", dokumentacioni shoqërues i raportit dhe mbi vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 28 Qershor 2022. Po ashtu, Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Universitetin Privat "Albanian University", GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e këtij institucioni të përfshirë në këtë proces, nga strukturat drejtuese të fakultetit, anëtarët e departamentit deri tek zyrat menaxheriale dhe horizontale siç janë burimet njerëzore, sekretaria e mësimore, si dhe takime me studentët e programit.


Ecuria e procesit është koordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.

"Albanian University" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 26/09/2022, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 24/32 Prot, datë 26/09/2022. "Albanian University" përcjell në ASCAL, me anë të shkresës me Nr. 545/1 Prot., datë 29/09/2022, "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm", ku konfirmon dakordësinë me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.82, datë 05.10.2019 janë:



1. Institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi për të reflektuar një përmbajtje më të gjerë të administrimit publik, në përputhje me qëllimin e programit të studimit.
2. Institucioni, të rekrutojë staf të ri akademik, të specializuar në fushën e administrimit publik, me qëllim mbulimin e të gjitha lëndëve të programit të studimit nga specialistë të fushës.



3. Institucioni, të rrisë përfshirjen e stafit akademik të këtij programi studimi në projekte kërkimore shkencore.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

1. Në kuadër të përmbushjes së rekomandimit nr.1, Institucioni ka zhvilluar procedurën e rishikimit të planit mësimor të programit Bachelor në “Shkenca Politik-Administrative”, duke reflektuar një përmbajtje më të gjerë të fushës së administrimit publik (*Evidencë 2.4_Procedura e rishikimit të kurrikulës*). **GVJ konstaton se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
2. Në kuadër të përmbushjes së rekomandimit nr. 2, Institucioni ka marrë masa për rekrutimin e stafit të ri akademik, të specializuar në fushën e administrimit publik. Të gjithë lëndët e programit të studimit mbulohen nga specialistë të fushës, me eksperiencë dhe kualifikime shkencore në fushën e lëndëve ku ato janë angazhuar (*Evidencë Tabelat Përmbledhëse të RVB_Tabela 12.1_Plani Mësimor i lidhur me personelin akademik; Evidencë 2.2_CV Personeli Akademik*). **GVJ konstaton se ky rekomandim është përmbushur plotësisht.**
3. Në kuadër të përmbushjes së rekomandimit nr. 3, institucioni nxit dhe mbështet përfshirjen e stafit akademik në projekte kërkimore shkencore dhe aktiviteteve të tjera shkencore, nëpërmjet mbështetjes institucionale dhe asaj financiare (*Evidencë 1.6_Marrëveshje bashkëpunimi; Evidencë 1.8_Erasmus+; Evidencë 3.2.c_Raport Vjetor Departamenti*). Nga vlerësimi i dokumentacionit të venë në dispozicion, sikurse edhe nga diskutimet e zhvilluara gjatë takimeve në institucion, evidentohet se institucioni ka marrë masat e nevojshme për të mbështetur përfshirjen e stafit akademik në projekte kërkimore shkencore, por ky mbetet një proces i cili ka nevojë për vijimin e mbështetjes institucionale por edhe një angazhim dhe iniciativë më të madhe nga vetë stafi akademik. **GVJ konstaton se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.**

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “Shkenca Politiko - Administrative”

I. OFRIMI, I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” ofrohet në shërbim të interesave kombëtare. Në Rregulloren e programit të studimit neni 4 “Misioni dhe objektivat e programit të studimit” cilësohet se “program i studimit është në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, strategjinë për zhvillim...”. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore të vendit. Në dokumentin e titulluar “Plani Strategjik i zhvillimit Institucional 2017-2022” në “Albanian University”, misioni i institucionit (gërma f&g) është të “ndihmoj në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal” si dhe “të kontribuoj në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri bashkëkohore”. (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; E.1.2- Plani Strategjik Institucional)
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në dokumentin e titulluar Plani Strategjik i zhvillimit Institucional në “Albanian University”, ndër të tjera parimet bazë të institucionit janë realizimi i misionit të tij në frymën e lirisë dhe në respekt të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave ..etj”. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, zbatohet në rrethanat kur kërkohet të thellohet e konsolidohet më tej vlerat demokratike dhe forcimi i administratës dhe institucioneve të vendit. Përmes shërbimit të procesit mësimor, program i studimit ndihmon në forcimin e vlerave akademike e atyre kulturore kombëtare. (E.1.2- Plani Strategjik Institucional)
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në hartimin e programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, aftësisë për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës. Ky program është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së Universitetit Privat “Albanian University” për të përgatitur specialistë dhe shkencëtarë të rinj. Fusha e studimeve Politiko-Administrative ka rëndësi të lartë pasi ndërlidh dijet politike me ato administrative duke zgjeruar e pasuron më tej profilin e Fakultetit të Shkencave Sociale përmes rëndësisë që institucioni i jep zhvillimit të shoqërisë në këtë dimension. (E.1.2- Plani Strategjik Institucional; E.1.4- Statuti i Albanian University)
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Në takimin me Dekanan e Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Politiko - Administrative si dhe bazuar në “Planin strategjik për zhvillimin e Institucionit 2017-2022”, RVB, programi i studimit është hartuar duke synuar të mbështesë e të nxisë nevojat e zhvillimit ekonomik në nivel lokal e qendror. Ky program studimi i shërben formimit të profesionistëve në sektorin publik në të gjitha nivelet përmes diplomës në “Bachelor” në “Shkenca Politiko Administrative”. Programi synon të furnizojë tregun me specialist njohës të politikës dhe administrimit

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



	duke i shërbyer rritjes së performancës së institucioneve publike dhe zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. (Mendimi i Dekanit; E.1.2- Plani Strategjik Institucional; Minutat e takimit Bsc Shkenca Politiko-Administrative.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2			
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në dokumente të tilla si: Plani strategjik për zhvillimin e Institucionit 2017-2022, Rregullorja e Përgjithshme e AU, Statuti i Albanian University, Rregullorja e Programit të Studimit konfirmohet dhe vlerësohet qasja e rëndësishme për zhvillimin e programit të studimit në harmoni me politikat zhvillimore të institucionit. Në këto dokumente theksohet misioni dhe vizioni i Albanian University për një qasje me objektiv zhvillimin profesional bazuar mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme (Rregullorja e programit të studimit neni 4 pika 6). (Evidencë; E.1.2- Plani Strategjik Institucional; E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU; E.1.4- Statuti i Albanian University; E.1.1.a-Rregullore e programit te studimit)		
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Statusi i Universitetit Privat “Albanian University”, dhe Rregullorja e Përgjithshme e AU e miratuar me vendim të Senatit Akademik nr 54/1, datë 10/10/2018, përcaktojnë në objektivat, parimet dhe shtyllat e aktiviteteve kryesore të institucionit drejtimit prioritar akademike dhe demonstrojnë qartë se programet e studimit hartohen në zbatim të tyre, në funksion të pasjes së një universiteti bashkëkohor dhe kontributiv për zhvillimin e dijes në vend. Në statut përcaktohen njësitë të cilat janë përgjegjëse dhe kujdesen për mbarëvajtjen e programeve. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të Departamentit të Shkencave Politiko - Administrative në lidhje me kriteret e organizimit e funksionimit të programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike- Administrative” si dhe të Statutit, Rregullores e planit strategjik të institucionit, rezulton se programi aplikohet në përputhje të plotë me to. (Evidencë; E.1.2- Plani Strategjik Institucional; E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU; E.1.4- Statuti i Albanian University; E.1.1.a-Rregullore e programit te studimit)		
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Programi i studimit në “Shkenca Politike - Administrative” ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative, njësi bazë në Fakultetin e Shkencave Shoqërore. Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit te këtij institucioni. (Evidencë: Mendimi i Dekanit; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e plotë të studentëve. Programi i studimit synon të pajisë studentët me një formim akademik bazë të përqëndruar në njohuri dhe kompetenca kyçe të domosdoshme për t’i përdorur në karrierën profesionale si specialist në fushën politike dhe administrative. Ky program studimi synon ti ofrojë studentit njohuri të thelluara në të dy drejtimet si politike dhe administrative duke i pajisur me aftësi analitike e bashkëkohore. Në Rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë objektivat për zhvillimin e mendimit kritik dhe formimit të vlerave më të larta dhe rritjen e standardeve të demokracisë. Ndryshimet e pësuara në kurrikulën e programit të studimit si dhe shqyrtimi i dokumenteve të tilla si: Rregullore e programit të studimit apo Rregullorja e Departamentit tregojnë qartë se departamenti koncepton që në nisje një përpjekje cilësore në shërbim të ofrimit të një kurrikule cilesore, dinamike dhe sfiduese. Gjithashtu përpjekja për të ofruar një diplomë të tillë, me këtë emertim duke ndërthurur politikën me administrimin është një përpjekje për të ofruar diçka ndryshe nga ajo çka ofrohet nga institucione të tjera. (Evidencë: E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit; E.1.1 - Rregullorja e Departamentit; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Dokumenti “E.1.7-Analiza e tregut të punës” trajton një njohje me programin e studimit, një pasqyrë mbi sfidat si dhe hapësirën e punësimit të profilit të studimit bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” në kontekst përshkruar. <i>Dokumenti nuk ka datë se kur është realizuar dhe cilën periudhë kohore mbulon ky studim.</i> Dokumenti trajton në mënyrë të përciptë ofertën që ky profil ofron në tregun e punës dhe se cilat janë hapësirat e punësimit por pa të dhëna statistikore. Në gjykimin e GVJ ky dokument është i pamjaftueshëm për t/u konsideruar si studim i mirëfilltë tregut pasi metodologjia e përzgjedhur dhe elementët e marrë në analizë janë sipërfaqësor. Vërehet se mungojnë të dhënat dhe kur analizohen të dhënat e vetë institucionit. Kështu në seksionin “Shqyrtimi i evidencave të punësimit të alumnit” nuk ka shifra, grafiku nuk është i qartë se sa alumni janë marrë në analizë, po kështu dhe tek pjesa “Shqyrtimi i ofertës së institucioneve të tjera të IAL-ve për programe të njëjta apo të ngjashme” padiskutim të nevojshme për një analizë të kësaj natyre por e pamjaftueshme për të parë tregun lokal dhe më gjerë të punësimit për këtë profil. Sugjerohet që në të ardhmen departamenti që ofron këtë program studimi të <i>ndërmarrë një studim cilësor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepen të gjitha analizat, statistikën, rezultatet dhe konsiderimet e rezultuara, mbi bazën e së cilës do të mund të përmiresohet apo ndertohej një projektion më i mirë për të ardhmen e këtij program studimi.</i> (Evidencë: E.1.7-Analiza e tregut të punës)</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion që GVJ realizoi me drejtues dhe stafin mësimor të programit, studentët si dhe përmes dokumentave strategjike të paraqitur dhe shqyrtuara, rezultoi se me objektivat formues, strukturën dhe përmbajtjen e programit është synuar në arritjen e dijeve, aftësive dhe kompetencave që i përgatisin studentët për tregun e punës. Kjo reflektohet në analizat vjetore dhe periodike të departamentit, në vlerësimin dhe mendimin e Dekanit të fakultetit, në rregulloren e programit të studimit apo</p>




dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.	në dokumenta të tjera. Gjithashtu përmirësimi i kurrikulës por dhe emërtimi i programit të studimit shikohet pozitivisht si nga stafi dhe studentët pasi ndërthurur dhe plotëson të dy fushat duke i ofruar më shumë shance të diplomuarve për të gjetur hapësirën e tyre në tregun e punës. (Evidencë: E.1.5-Kurrikulat; E.3.2.c-Raport Vjetor Departamenti; Mendimi i Dekanit; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Fakulteti i Shkencave Shoqërore pjesë e të cilës është dhe Departamenti i Shkencave Politiko - Administrative është krijuar që në vitin 2005 (Evidencë H.2-Licensimi nga MASH) . Brezi i parë i të diplomuarve në këtë program studimi është realizuar në vitin 2008. (Evidencë E.1.7-Analiza e tregut të punës) . Universiteti privat “Albanian University” përbën një institucion të arsimit të lartë të mireorganizuar dhe me eksperiencë të konsiderueshme në fakultetin pjesë e të cilës është dhe ky program studimi. Bazuar në vendimin e Senatit Akademik nr.27 datë 15.09.2021 përmes riorganizimit departamenti u emërtua “Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko – Administrative” (Evidencë H.1-Riorganizimi i Departamenteve) . Struktura institucionale e Albanian University-së është në funksion të misionit dhe e organizuar në përputhje me fushën akademike specifike për ofrimin e programit të studimit bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”. Sasia, kualifikimi dhe cilësia e stafit akademik të brendshëm kryesisht dhe stafit të jashtëm, janë tregues të përvojës dhe kapaciteteve të duhura në ofrimin e këtij programi. (Evidencë H.2-Licensimi nga MASH; E.1.7-Analiza e tregut të punës; H.1-Riorganizimi i Departamenteve; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Universiteti privat “Albanian University” është i organizuar në tre Fakultete sipas strukturës dhe Statutit të AU të miratuara në vitin 2016 (Evidencë E.1.4- Statuti i Albanian University) . Fakultetit të Shkencave Shoqërore ku përfshihet edhe programi i studimit ka një eksperiencë mbi 17 vite. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe është i rregjistruar si program i ciklit të parë bachelor, niveli 6 i Kornizës Kombëtare të kualifikimeve dhe përfshihet në fushën kryesore “Shkenca Sociale”. (Evidencë Extra.1-Model Diplome)
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një	Programi ofrohet nga njësia bazë që është Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko – Administrative, i cili miraton programet mësimore dhe propozon ndryshimet e nevojshme pranë organeve drejtuese të Universitetit. Organizimi i institucionit, i cili ka në përbërje 3 fakultete (dhe departamentet përkatëse) krijon mundësinë për zhvillimin e një programi bachelor me lëndë të profilit dhe ndër-disiplinore, i cili mbështetet nga kontributi jo vetëm i departamentit përkatës por edhe nga fakultetet e tjera. GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën e realizuar në

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	institucion vërejtë që njësia bazë ishte në korrent të përgjegjësive në lidhje me programin e studimit dhe ishte e angazhuar seriozisht për vënien e tij në jetë. Në tërësi, departamenti dhe anëtarët e tij, shefi i departamentit dhe disa prej lektorëve dëshmuar vetëdije dhe përgjegjësi në realizimin e programit të studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendim-marrëse dhe administrative. Strukturat akademike janë të ndërlidhura dhe propozojnë pranë strukturave menaxheriale ndryshimet e nevojshme. Gjithashtu, detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloret e institucionit. Bazuar në takimin me dekanen e fakultetit e përgjegjësën e departamentit, si dhe në dokumentacionin përkatës, konstatohet se programi bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” zbatohet në kushtet e ndarjes së detyrave e përgjegjësive mes njësisë dhe personelit. Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko – Administrative ka hartuar rregullore të programit të studimit dhe mban në mënyrë periodike mbledhjet për mbarëvajtjen e këtij programi studimi. Përveç përgjegjësit të departamentit përmes shkresës nr. 916/2 dt.29.10.2021 janë caktuar dhe koordinatorët e programeve të studimit (Evidenca E.2.3-Koordinatori i programit të studimit; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit; E.1.1 -Rregullorja e Departamentit).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Institucioni ka arritur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm. Në Evidencën E.1.6-Marreveshje Bashkepunimi pasqyrohen rreth 14 marrëveshjet bashkëpunimit të Albanian University me institucionit të tjera në vend qofshin këto institucione shtetërore apo dhe institute dhe shoqata të ndryshme. Gjithashtu në dokumentin Plani Strategjik Institucional.2017-2022 në pikën “Marrëdhëniet me jashtë” fq.22-27 dëshmohet për vizionin dhe shtyllat e ndërtimit të raporteve me institucionet e tjera në kuadër të zhvillimit të marrëdhënieve me aktorë të ndryshëm (Evidencë E.1.2- Plani Strategjik Institucional).
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në Evidencën E.3.2.b-Raport Semestral Departamenti dëshmohet se departamenti harton si pjesë të integruar informacionin analitik që lidhet me përfitimet e njësisë nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Konkretisht në dokumentin e sipërcituar në fq. 25-26 trajtohet specifikisht në formë tabelare se cilat janë marrëveshjet e firmosuar, afatet kohore dhe se për çfarë i shërbejnë departamentit këto marrëveshje. Vërehet se këto marrëveshje shërbejnë për praktika mësimore; veprimtari të përbashkëta shkencore apo shkëmbim kapaciteteve njerëzore etj. Marreveshjet e bashkepunimit dhe efektiviteti i tyre ka rëndësi jo vetëm në procesin e realizimit të praktikave mesimore por dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore të njësisë.
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të	Institucioni ka marrëveshje me institucione publike dhe jopublike që ndihmojnë studentët për kryerjen e praktikës. Këto marrëdhënie janë të rëndësishme për zhvillimin dhe zbatimin e praktikës. Sikundër u trajtua në takimin e GVJ me studentët, një pjesë e tyre e kanë realizuar praktikën pranë vendbanimeve të tyre

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	dhe IAL ka bërë marrëveshje me institucionet lokale (psh. Bashkia Lezhë) për t'iu mundësuar studentëve këtë proces. Në Rregulloren e FSHSH, neni 37 fq.17 thuhet se “Praktika profesionale zhvillohet në institucionet e caktuara nga fakulteti ose zgjedhur nga vetë studenti, në drejtimin e pedagogut të ngarkuar”. Përmes praktikës mësimore studentët mësojnë një sërë aftësish teknike që i japin atyre një mundësi më shumë për të qenë të suksesshëm në tregun e punës. Praktika mësimore mbikqyret nga pedagogu mentor. (Evidencë: Minutat e Takimit; E.2.1-Rregullore e FSHSH; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)		
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Sikundër është bërë e qartë dhe në RVB “Departamenti nuk ofron trajnime të mëtejshme profesionale pas mbarimit të studimeve”. (Evidencë: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kreditë (Evidencë 1.5_Kurrikula), në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar).
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në fushën e shkencave politike dhe atyre administrative. Lëndët e programit të studimit i ofrojnë studentëve njohuri të përgjithshme në disiplinën sociologjike, historike, filozofike, sikurse dhe njohuri specifike në disiplinën ekonomiko-sociale, juridike, politike dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparura në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit ofron njohuri të përparura në fushën e shkencave politiko-administrative, ku përfshihen si aspektet teorike ashtu edhe ato të parimeve akademike të fushës (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Si struktura dhe përmbajtja e kurrikulës (Evidencë 1.5_Kurrikula), ashtu edhe syllabuset e lëndëve (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), garantojnë që programi i studimit BA në “Shkenca Politiko-Administrative”, ofron njohuri të përparura në fushën e studimit. Gjithashtu, ky program mundëson aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive që pritet të kenë përfituar në kurset teorike. Programi i ofron studentëve njohuri të përgjithshme të mbështetura në lëndë të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>formimit bazë të karakterit sociologjik, historik dhe filozofik, duke vijuar me njohuri specifike të tilla si njohuri ekonomiko-politike, juridike, administrative, politike dhe njohuri të marrëdhënieve ndërkombëtare duke vendosur objektiva specifike për përgatitjen e politologëve dhe ekspertëve në fushën e shkencave politiko administrative. Në përfundim të këtij programi studentët do të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë analitike të nevojshme për të trajtuar problematikat e shoqërisë bashkëkohore. (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit, Neni 4 Objektivat e programit). Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit mundësojnë vijimin në ciklin pasardhës ose për t'u punësuar në sektorin publik dhe privat, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekspert në administratën publike, në institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale. • Ekspert në institucione dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare, parti politike, media, etj. 			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi BA në “Shkenca Politiko-Administrative” ofron mundësinë e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave në fushën e shkencave politiko-juridike, të përshtatshme për një program të ciklit të parë. Ndërthurja e komponentëve teorik me ato praktik, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e shkencave politiko-administrative (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Programi ndërthur njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në Kategorinë A, me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në Kategorinë B (Evidencë 1.5_Kurrikula).</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit BA në “Shkenca Politiko-Administrative” është i organizuar sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar).</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse të shprehur në kreditet ECTS (Evidencë 1.5_Kurrikula). Programi është i organizuar në tre vite akademike (180 ECTS), 6 semestra, me një shpërndarje optimale të ngarkesës. Kategoria A, ka një ngarkesë prej 36 ECTS dhe ka të grupuara lëndë për përgatitje metodologjike (Lexim Kritik dhe Shkrim Akademik) dhe lëndë për kulturë të përgjithshme (Teoritë Sociologjike, Filozofi dhe Histori Botërore). Në kategorinë B, e cila ka një ngarkesë prej 94 ECTS, janë të grupuara lëndët për përgatitjen për disiplinën e shkencave politiko-administrative (Shkenca Politike, Teori dhe Institucione të së Drejtës, Histori e Ideve Politike, Administrim dhe Politika Publike, Aftësi Menaxheriale, Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, etj). Kategoria C, me një ngarkesë prej 23 ECTS, grupon lëndë ndërdisiplinore (lëndë me zgjedhje), të tilla si: Psikologji Politike, Antropologji Sociale dhe Politike, Komunikim Politik, Hartimi dhe Menaxhimi i Projekteve, etj. Kategoria D, me një ngarkesë prej 21 ECTS, përfshin lëndët plotësuese: Anglisht, Metodatat e Kërkimit Shkencor sikurse dhe Praktikën Mësimore. Kategoria E përfshin detyrimin përmbyllës, dhe ka një ngarkesë prej 6 ECTS (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi II.2				
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti, në bashkëpunim edhe me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC), kryejnë vlerësimin e brendshëm periodik për rezultatet dhe nivelin cilësor të aktiviteteve formuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore, (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 3.2.a_Raport Vlerësimi Semestral i Personelit Akademik; Evidencë 3.2.b_Raport Semestral Departamenti; Evidencë 3.2.c_Raport Vjetor Departamenti; Evidencë 3.2.d_Formulari i Vlerësimit nga Drejtuesi i Departamentit), sikurse dhe procesin e vlerësimit të jashtëm, konform detyrimeve ligjore në fuqi (Evidencë H.5_Vendimi i BA Nr. 82, datë 05.10.2019, “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, të Universitet Privat “Albanian University””).			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Departamenti, me miratim të Dekanit, ka caktuar Dr. Julian Myftari si koordinator për programin Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” (Evidencë 2.3_Koordinatori i Programit të Studimit). Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, dhe informon vazhdimisht titullarin e njësisë bazë, duke raportuar në mënyrë periodike pranë tij (Evidencë 1.1_Rregullorja e Departamentit).			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore (Evidencë 1.1_Rregullorja e Departamentit; Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme e AU; Evidencë 1.4_Statuti i AU).			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	Numri dhe shkalla e kualifikimit të personelit akademik në nivel njësie kryesore dhe njësisë bazë, janë konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në vitin akademik 2021-2022, në nivel njësie kryesore janë angazhuar 32 PAE dhe 54 PAK. Në nivel njësie bazë, janë angazhuar 15 PAE (2 Kategoria ‘Profesor’, 10 ‘Doktor’, dhe 3 MSc.) dhe 27 PAK (1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 6 Dr., 16 Msc), të mbështetur nga 9 PA (Evidencë Tabela 1 & 2). Ky kriter është përmbushur edhe në vitet e mëparshme akademike.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore (Evidencë 1.1_Rregullorja e Departamentit; Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme e AU; Evidencë 1.4_Statuti i AU).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara në institucion, konstatohet se njësitë përgjegjëse, disponojnë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimit. Ky konstatim mbështetet edhe në tërësinë e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni, në kuadër të procesit të akreditimit periodik. Drejtuesi i Departamentit, në bashkëpunim edhe me Dekanin dhe Koordinatorin e Programit, grumbullojnë dhe analizojnë informacionin e plotë mbi programin, i cili u shërben për të marrë edhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor; Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve; Evidencë 3.2.c_Raport Vjetor Departamenti; Evidencë 3.2.d_Formulari i Vlerësimit nga Drejtuesi i Departamentit; Evidencë 2.3_Koordinatori i Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit BA në “Shkenca Politiko-Administrative” është i organizuar në lëndë/module, praktikë dhe aktivitete formuese, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar).</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Të gjitha lëndët/modulet, sikurse dhe detyrimet e tjera të programit të studimit, të tilla si praktika mësimore dhe detyrimet përmbyllëse (diplomimi), janë të vlerësuara me kredite ECTS, të ndara në 3 vite akademike dhe 6 semestra (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor). Shpërndarja e ngarkesës mësimore ndër vite është e balancuar, sikurse dhe strukturimi i lëndëve, duke nisur me lëndë të karakterit të përgjithshëm në vitin e parë, e deri tek Praktika Mësimore dhe Detyrimet Përmbyllëse në semestrin e fundit, vlerësohen si të përshtatshme.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor i detajuar, është pjesë integrale e Rregullores së Programit (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Në planin mësimor përfshihet informacioni i nevojshëm për lëndët/modulet, viti dhe semestri kur ofrohet lënda/moduli, ngarkesën mësimore, leksionet, seminarët, ushtrimet, orët në auditor dhe jashtë tij, sikurse dhe numri i provimeve. Programi ka në përbërjen e tij 19 lëndë të detyrueshme, 3 lëndë me zgjedhje, praktikën mësimore dhe detyrimin përmbyllës, të shpërndara në kategoritë A-E. Ngarkesa totale e programit të studimit është 180 ECTS, me një shpërndarje prej 60 ECTS/1500 orë, në secilin vit akademik. Në vitin e I, programi ka të parashikuar 615 orë në auditor dhe 885 orë studim individual, në vitin e II ky raport është 645 orë në auditor/ 855 orë studim individual ndërsa në vitin e III, 653 orë në auditor/ 547 orën studim individual. Në planin mësimor detajohen orët për leksionet/ seminarët/ ushtrimet/ laboratorët/ detyrat, si në auditor ashtu edhe orët e studimit individual. Secila prej lëndëve ka të parashikuar zhvillimin e një provimi final, ndërsa mënyra e vlerësimit të dijeve dhe frekuentimi përcaktohen në Rregulloren e Programit, sikurse dhe syllabusin e lëndëve (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë; 4.5_Syllabuset e lëndëve). Mënyrat e vlerësimit të dijeve për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive – 10%

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al


E-mail: info@asc.al




	<ul style="list-style-type: none"> • Plotësimi i detyrimeve (ushtrime, detyra, projekte) – 10% • Testimet gjatë vitit – 20% • Provimi përfundimtar – 60%. <p>Frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në të paktën 75% të tyre ndërsa frekuentimi i praktikës mësimore është i detyrueshëm në masën 100% (për studentët që mungojnë me arsye në jo më shumë se 25% të seancave të praktikës, planifikohen deri në dy seanca plotësuese) (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit, Neni 15 Frekuentimi, Neni 25 Kontrolli ose Vlerësimi i dijes).</p>
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 5.1_Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve). Për vetë natyrën e fushës së programit të studimit, fusha e shkencave politiko-administrative, kriteret e pranimit janë vetëm ato të përgjithshme dhe nuk ka kriteret specifike.
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit (Evidencë 1.5_Kurrikula) , plani mësimor (Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor) , sikurse dhe programet lëndore (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve) , vlerësohet se janë të plota dhe përmbajnë informacionet e nevojshme për të gjithë komponentët mësimor. Të gjitha lëndët e programit të studimit, shoqërohen me syllabusin përkatës, në të cilin janë të reflektuara të gjitha elementet e nevojshme, duke nisur nga titulli i lëndës, lektori, ngarkesa (e shprehur në ECTS dhe e detajuar në orë leksion, seminar dhe studim individual), viti dhe semestri kur zhvillohet lënda, kategoria e lëndës, adresa elektronike e lektorit, përmbledhja dhe rezultatet e të nxënit, temat sipas javëve dhe literatura përkatëse, metodologjia e mësimdhënies, frekuentimi dhe kontrolli i vazhdueshëm, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar, sikurse dhe element nga Kodi i Etikës (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve). Përveç lëndëve të programit, në planin mësimor përcaktohen të dhëna edhe për praktikën mësimore dhe detyrimin përmbyllës. Praktika mësimore, e cila ka një ngarkesë prej 5 ECTS (125 orë), zhvillohet në semestrin e I, të vitit të III. 115 orë zhvillohen në auditor (institucion) ndërsa 10 orë janë të parashikuara si studim individual (i cili lidhet kryesisht me plotësimin e formularëve të vlerësimit). Ndërsa për komponentin e detyrimit përmbyllës, i cili ka një ngarkesë prej 6 ECTS, janë të përcaktuara 12 orë në auditor dhe 138 orë studimi individuale. Ngarkesa totale në auditor e studentëve për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative” është 1902 orë, e shpërndarë sipas komponentëve: <ul style="list-style-type: none"> • Leksione – 1174 orë në auditor. • Seminare – 460 orë në auditor. • Ushtrime/ Laboratorë – 106 orë në auditor. • Forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale – 35 orë në auditor. • Praktikë profesionale – 115 orë në auditor. • Diploma/Provimi Formimi – 12 orë në auditor (Evidencë Tabela 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit).
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmirësimi dhe përditësimi i programit të studimit, është një proces i cili evidentohet si nga dokumentacioni i administruar (Evidencë 2.4_Procedura e rishikimit të kurrikulës; Evidencë 6.5.b_VR për Konsulent të Zhvillimit të Kurrikulave; Evidencë 6.6_Rregullore për Mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor) , ashtu edhe gjatë diskutimeve në takimet e zhvilluar në institucion. Këto ndryshime lidhen si me përditësimin

	<p>e syllabuseve ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Një ndër ndryshimet më të rëndësishme të bëra në këtë program studimi, janë ato të vitit 2020, bazuar në rekomandimet e lënë nga akreditimit i mëparshëm. Ku proces ka kaluar në disa faza:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Propozimi i Departamentit për ngrijën e grupit të punës për disa ndryshime në kurrikulën e programit Bachelor në 'Shkenca Politike'. 2. Miratimi i propozimit nga Dekani. 3. Propozimi i Departamentit drejtuar Dekanit, mbi ndryshimet e planit mësimor, sipas propozimeve të mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> a. Lënda Histori e Mendimit Ekonomik nga 6 ECTS bëhet me 5 ECTS. b. Lënda Elementet e Qeverisjes dhe Proceset Zgjedhore, nga lëndë vjetore me 10 ECTS kalon si lëndë semestrare me 6 ECTS. c. Lënda Aftësi Menaxheriale nga Kategoria C kalon në Kategorinë B. d. Lënda Origjina dhe Analiza e BE-së kalon nga lëndë vjetore (9 ECTS) në lëndë semestrare (5 ECTS). e. Lënda Financa Publike kalon nga Kategoria C në Kategorinë B. f. Lënda Metodat e Kërkimit Shkencor nga 9 ECTS bëhet me 8 ECTS. g. Praktika Mësimore nga 4 ECTS bëhet me 5 ECTS. 4. Përcjella e propozimit të Departamentit nga Dekani tek Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave. 5. Miratimi nga Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe përcjella tek Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. 6. Miratimi i propozimit nga Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin dhe përcjella e propozimit Senatit Akademik. 7. Miratimi i ndryshimeve nga Senati Akademik dhe përcjella për dijeni Ministrisë përgjegjëse për arsimin. 8. Kthim përgjigje nga Ministria përgjegjëse për arsimin për konfirmimin e marrjes në dijeni për ndryshimet e bëra në programin e studimit. <p>GVJ konstaton se institucioni ka ndjekur praktikën e plotë dhe të saktë lidhur me ndryshimet e kurrikulës dhe ka të arkivuar dosjen e plotë për këto ndryshime (Evidencë 2.4_Procedura e rishikimit të kurrikulës).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet përbashkë	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4 Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit BA në "Shkenca Politiko-Administrative" është i organizuar në 180 ECTS, 3 vite akademike, 6 semestra, me një shpërndarje të balancuar të ngarkesës të shprehur në kreditë ECTS (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor), në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Duke iu referuar kornizës ligjore, një kredit (ECTS) korrespondon me 25 orë pune të një studenti dhe sasia mesatare e punës së përfunduar gjatë një viti të studimeve për një student është 60 (gjashtëdhjetë) ECTS ose 1500 (një mijë e pesëqind) orë të orarit të punës së studentëve, i cili përfshin orë në auditor dhe orë të punës së pavarur.



<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit “Shkenca Politiko-Administrative” vlerësohet si i përshtatshëm në funksion të përmbajtjes, objektivave formues por edhe mundësi të punësimit apo vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e fundit me praktikën mësimore dhe detyrimet përmbyllëse. (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor). Shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, integruese dhe plotësuese, ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>Vlerësohet se struktura, organizmi dhe përmbajtja e programit të studimit (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor), mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të parë, Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, të përcaktuar në Rregulloren e tij (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e shkencave politiko-administrative (Evidencë 1.5_Kurrikula), dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike), por të ndërthurura dhe me lëndë të cilat lidhen me kontekstin e Shqipërisë.</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, sikurse dhe përmbajtja e tij, mundësojnë arritjen e objektivave formues (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 1.5_Kurrikula), transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve (për shkak të ngjashmërisë me programe të ofruara nga IAL të tjera), sikurse dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve (duke qenë se i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme), ose për të vijuar në programet e studimit të ciklit të dytë. Përfundimi i këtij programi i mundëson studentëve aftësi dhe kompetenca për t'u punësuar si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, në pozicione të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ekspert në administratën publike, në institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale. • Ekspert në institucione dhe organizata vendase dhe ndërkombëtare, parti politike, media, etj.
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Përditësimi i programeve të lëndëve/moduleve, si një ndër komponentët e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit (Evidencë 2.4_Procedura e rishikimit të kurrikulës; Evidencë 6.5.b_VR për Konsulent të Zhvillimit të Kurrikulave; Evidencë 6.6_Rregullore për Mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor), është një proces periodik i cili inicohet kryesisht nga titullarët e lëndëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), konstatohet se ky kriter nuk përmbushet në pjesën më të madhe të lëndëve. Ky element u diskutua edhe gjatë takimeve të zhvilluara në institucion dhe argumenti kryesor i dhënë nga stafi akademik, lidhet me mungesën e teksteve të viteve të fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Rekomandojmë Institucionin që të marrë masa për sigurimin e literaturës për lëndët kryesore të programit të studimit, në të cilat nuk përmbushet ky kriter.</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit, për shkak të mënyrës së organizimit (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik), garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, për studentët që përfundojnë një program studimi të ciklit të parë, në fushën e</p>

për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>shkencave politiko-administrative Pesha që zënë lëndët sipas kategorive, krahasuar me parashikimet ligjore në fuqi, është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A, ka një ngarkesë prej 36 ECTS (20%) – standardi 15-20%. • Kategoria B, ka një ngarkesë prej 94 ECTS (52%) – standardi 50-55%. • Kategoria C, ka një ngarkesë prej 23 ECTS (12.8%) – standardi 12-15%. • Kategoria D, ka një ngarkesë prej 21 ECTS (11.7%) – standardi 10-15%. • Kategoria E, ka një ngarkesë prej 6 ECTS (3.3%) – standardi 3-5%. <p>(Evidencë 1.5_Kurrikula).</p>			
Kriteri 8. Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përbajtja e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politiko-Administrative”, mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të dytë, sikurse dhe mundësinë e punësimin të të diplomuarve në këtë program studimi (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 1.5_Kurrikula). Lëndët e këtij programi studimi, i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e shkencave politiko-administrative, por edhe me aftësi për kërkimin shkencor, një element i rëndësishëm kryesisht për studentët që synojnë vijimin e programeve Master i Shkencave apo edhe të programeve të ciklit të tretë.</p>			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	<p>Si nga dokumentacioni i administruar, ashtu edhe nga vizitat e zhvilluara në institucion, deklarohet se në funksion të përmirësimit të përbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen me bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës (Evidencë 1.2_Plani Strategjik Institucional; Evidencë 1.6_Marrëveshje Bashkëpunimi; Evidencë 1.7_Analiza e Tregut të Punës). GVJ konstaton se pavarësisht ekzistencës së akteve të brendshme rregullatore dhe vizionit të drejtuesve të njëjësive përgjegjëse, është e vështirë të evidentohen raste praktikash të mira për këtë program studimi, në funksion të bashkëpunimit me partnerë nga tregu i punës.</p> <p><i>Rekomandohet që për vetë rëndësinë e bashkëpunimit midis akademisë dhe tregut të punës, ky proces të zhvillohet në mënyrë periodike dhe të strukturuar dhe të reflektohet në mënyrë të dukshme në programin e studimit.</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Në këtë program studimi, janë angazhuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin akademik 2021-2022 është angazhuar një personel akademik prej 16 personash (8 PAE dhe 8 PAK). • Në vitin akademike 2020-2021 janë angazhuar 18 persona (9 PAE dhe 9 PAK). • Në vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar 18 persona (9 PAE dhe 9 PAK) (Evidencë Tabela 6_Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit). <p>Personeli i angazhuar, përbush kërkesat ligjore në fuqi, lidhur me kualifikimin e tyre. Sipas të dhënave të depozituara nga ana e institucionit,</p>

	rezultun se 85 % e programit, realizohet nga Personel Akademik Efektiv (Evidencë Tabela 12_Plani mësimor i lidhur me personelin akademik).				
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, sipas kualifikimit akademik dhe statusit të punësimit (PAE/PK) rezultun si më poshtë vijon (Evidencë Tabela 7_Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik, sipas kualifikimit):</p> <p>PAE:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin akademik 2021-2022: 1 Prof. Dr., 1 Prof. Asoc. Dr., 6 Dr. • Në vitin akademik 2020-2021: 1 Prof. Dr., 7 Dr., 1 MSc. • Në vitin akademik 2019-2020: 1 Prof. Dr., 7 Dr., 1 MSc. <p>PAK:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin akademik 2021-2022: 2 Prof. Asoc. Dr., 3 Dr., 3 MSc. • Në vitin akademik 2020-2021: 2 Prof. Asoc. Dr., 3 Dr., 4 MSc. • Në vitin akademik 2019-2020: 2 Prof. Asoc. Dr., 3 Dr., 4 MSc. <p>Lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis PAE/PAK rezultun se (Evidencë Tabela 12.1_Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin akademik 2021-2022: 85.7% PAE/ 14.3% PAK • Në vitin akademik 2020-2021: 79.1% PAE/ 20.9% PAK • Në vitin akademik 2019-2020: 68.7% PAE/ 31.3% PAK <p>GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesëshme i angazhuar në këtë program studimi, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik. Gjithashtu, përqindja e ngarkesës midis PAE/PAK është konform parashikimeve ligjore dhe institucioni ka garantuar që ky trend të jetë në rritje pozitive (Standardi: 70% PAE/ 30% PAK).</p>				
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi, rezultun se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore, sikurse dhe eksperiencia profesionale, janë në përputhje me programin e studimit dhe lëndët/modulet në të cilat ato janë të angazhuar (Evidencë 2.2_CV Personeli Akademik).				
Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tjerë (Evidencë 1.6_Marrëveshje Bashkëpunimi), të cilat vlerësohen të përshtatshme kryesisht për zhvillimin e praktikës profesionale. Edhe për komponentët e tjerë, të tillë si Diplomimi (si me Provim Diplomimi ashtu edhe Temë Diplome), vlerësohet se institucioni garanton kapacitetet e nevojshme për realizimin e tyre me sukses (Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës). Gjatë takimit me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, u evidentuan raste të suksesshme kur stafi akademik (kryesisht ai i jashtëm) kishin facilituar procesin e realizimit të praktikave profesionale të studentëve, në institucionet ku ata janë të angazhuar me kohë të plotë.				
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës i angazhuar në këtë program studimi, i cili është më shumë i natyrës administrative sesa mësimor-shkencor, konsiderohet i përshtatshëm. Për vetë natyrën e programit të studimit, vlerësohet se ky kriter përmbushet (Evidencë Tabela 2_Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ).				
	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	Përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përbën një objektivi të rëndësishëm të institucionit, e përcaktuar në dokumente kryesore strategjike (Evidencë 1.2_Plani Strategjik Institucional; Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme). Në funksion të përmbushjes së këtij objektivi, institucioni zhvillon trajnime për stafin akademik dhe administrativ (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik; Evidencë 1.3_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Administrativ; Evidencë 4.4_Manuali i Përdorimit të Platformës TEAMS).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Procesi i monitorimit dhe vlerësimit periodik është një proces i cili përfshin Departamentin, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, sikurse dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. Ky proces realizohet nëpërmjet mekanizmave të ndryshme, ku ndër më kryesorët janë anketat e studentëve, fokus-grupet, raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë (Evidencë 3.2_Raporte Vlerësimi; Evidencë 3.3_Pyetësorët; Evidencë 3.4_Fokus-Grupe). Përveç NJSBC në nivel institucional, vepron edhe një njësi në nivel Departamenti (Evidencë 3.5_Grupi i Sigurimit të Cilësisë në Nivel Departamenti).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Në dy nga mekanizmat kryesore për mbledhjen e të dhënave në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshirja e studentëve është në mënyrë të drejtpërdrejtë (Evidencë 3.3_Pyetësorët; Evidencë 3.4_Fokus-Grupe). Gjatë takimit të zhvilluar me studentët e këtij programi studimi, doli në pah se studentët kishin hapësirat e nevojshme për të adresuar ankesat e ndryshme që mund të kishin lidhur me procesin mësimor, por edhe aspekte të tjera të jetës studentore.
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Raporti vjetor i hartuar nga NJSBC, i paraqitet fillimisht Komisionit për Vlerësimin Institucional, i cili ja paraqet Senatit Akademik (Evidencë 6.8_Rregullore e NJSBC). Raportet e gjeneruar nga përdorimi i instrumenteve si pyetësorët dhe fokus-grupet, i përcillet Drejtuesit të Departamentit, i cili diskuton problematikat në mënyrë individuale me stafin. Rezultatet e vlerësimeve bëhen pjesë e Raportit Semestral dhe Vjetor të Departamentit (Evidencë 3.2 a.b_Raport Vlerësimi Semestral/Vjetor i Departamentit). Rezultatet e përmbledhura të vlerësimit, janë pjesë e Raportit vjetor të Institucionit, i cili publikohet në faqen zyrtare të IAL (https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/Raport-vjetor-v.a-2020-2021-pdf.pdf).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	Bazuar në gjetjet e raporteve të evidentuara në kriteret e mësipërme, njësitë përgjegjëse nxisin dhe inkurajojnë përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik) por edhe diskutimit individual apo gjatë mbledhjeve të departamenteve, të problematikave të evidentuara dhe diskutimit mbi masat e nevojshme për përmirësimin e cilësisë. Ky element u evidentua edhe gjatë takimeve në institucion.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, të tilla si leksionet, seminarët, detyrat e kursit, etj., janë të përcaktuara në planin mësimor (Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor), në syllabuset e lëndëve (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të Studimit (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.	Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me përfaqësues të ndryshëm, u konstatua se personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies. Duke qenë se fusha e programit të studimit, Shkenca Politiko-Administrative, ka një natyrë kryesisht teorike, format klasike të mësimdhënies janë mbizotëruese, të cilat adoptohen edhe në bazë të nevojave të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Përtej parashikime në aktet e brendshme rregullatore mbi aspektet didaktike (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit), institucioni mbështet stafin akademik të përcaktojë në mënyrë autonome metodat pedagogjike, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të programit të studimit në tërësi, por edhe lëndëve apo moduleve të veçanta, si pjesë përbërëse të kurrikulës. Zhvillimi i trajnimeve, është një tjetër komponent që ndikon në përmbushjen e këtij kriteri. Trajnimet e zhvilluara nga Institucioni, të tilla si: "Vlerësimi psikosocial dhe Motivimi i studentëve për të rritur vetefikasitetin e të nxënies" sikurse dhe "Shkëmbim eksperience midis stafit akademik mbi organizimin e një ore mësimi", vlerësohen si mbështetje efikase e institucionit për personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Edhe trajnimi mbi zhvillimin e aftësive për përdorimin e ITC, "Përdorimi i google classroom" vlerësohet gjithashtu si një mbështetje efikase, duke marrë në konsideratë edhe faktin që për shkak të Covid-19, të gjithë proceset mësimore filluan të zhvillohen online dhe jo i gjithë personeli akademik mund të ketë të njëjtat aftësi në ICT (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik).
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të	Gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, por edhe me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe përdor

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	metoda të ndryshme të mësimdhënies, sipas tematikave dhe profilit të lëndëve ku ata janë të angazhuar, si titullar apo si asistentë.			
Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies, duke përfshirë edhe studentët, parashikohet në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1.2_Plani Strategjik Institucional). Implementimi i instrumenteve të tillë, si pyetësorët dhe fokus grupet, garantojnë përfshirjen e studentëve në këtë proces periodik (Evidencë 3.3_Pyetësorët; Evidencë 3.4_Fokus-Grupe).			
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, u konstatua si nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe me studentët, ashtu edhe nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, në të cilat, në seksionin e përshkrimit të seminarit për secilën temë, evidentohen element të këtij kombinimi (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve).			
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Përdorimi i metodave inovative, sikurse dhe kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, garantojnë që format dhe metodat e mësimdhënies të inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit. Organizimi i detyrave në grup apo individuale, prezantimet, etj., ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri, i cili u konstatua edhe gjatë takimeve të zhvilluara me studentët e këtij programi studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme, të cilat janë të pastra dhe përgjithësisht të mirëmbajtura. Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit, ka një sipërfaqe totale prej rreth 4618 m², ku ndër mjedise kryesore mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 19 salla për leksione/seminare, me sipërfaqe 1511 m². • 1 sallë për aktivitete promovuese, me sipërfaqe 245 m². • 1 laborator informatike - me sipërfaqe 35 m². • 1 sallë biblioteke - me sipërfaqe 249 m². • 1 mjedis për fotokopje, me sipërfaqe 7 m². • 1 zyrë informacioni për studentët, me sipërfaqe 6 m². • 2 mjedise shlodhëse si kafeteri/fast-food, me sipërfaqe 567 m². • 6 nyje hidrosanitare, me sipërfaqe 106 m². <p>Edhe mjediset e dedikuara për stafin, të cilat kanë një sipërfaqe prej 205 m², vlerësohen si të përshtatshme dhe përbëhen nga zyrat për drejtuesit (1), sekretarinë mësimore (2), departamentet dhe personelin akademik (2), financën (2), NJSBC (1), Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve (1), IT (2) dhe nyjet hidrosanitare për personelin akademik dhe administrativ (2). (Evidencë Tabela 16_Mjediset e Fakultetit/Njësi Bazë; Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).</p>
Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë	Sallat në të cilat zhvillohen leksionet dhe seminarat, janë të pajisura me logjistikën e nevojshme, të tilla si kompjuter, projektor, akses në internet. Në dispozicion të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

funkionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	zhvillimit të orëve në të cilat është i nevojshëm përdorimi i IT, institucioni është i pajisur me laboratorin e informatikës. Nisur nga natyra e programit të studimit, vlerësohet se ky kriter është i plotësuar.
Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Laboratori i informatikës, sikurse dhe sistemi i IT në tërësinë e tij, shfrytëzohet nga personeli akademik dhe nga studentët e këtij programi studimi, në funksion të realizimit të procesit mësimor.
Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset e çdo lënde (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), vlerësohet si e përshtatshme në funksion të garantimit të marrjes së dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Sikurse është evidentuar edhe në kriteret e mëparshme, literatura bazë jo gjithmonë është e 5 viteve të fundit. Gjatë takimeve të zhvilluara me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi, u evidentua se kjo tejkalohet nëpërmjet leksioneve të shkruara nga pedagogët e lëndëve apo nga rastet që ato trajtojnë gjatë leksioneve dhe seminareve, të cilat janë të lidhura me zhvillimet më të fundit në disiplinat përkatëse.
Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	Fondi i bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi, vlerësohet si i përshtatshëm (Evidencë 4.3_Lista e Literaturës së Bibliotekës). Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. Pjesë e bibliotekës janë edhe libraritë online, të tilla si EBSCO dhe ERIC, të cilat mund të aksesohen nga ambientet e bibliotekës, si nga personeli akademik ashtu edhe nga studentët, në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përfaqësuara me programin e studimit.	
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, u konstatua se infrastruktura laboratorike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga ana e studentëve. Kjo infrastrukturë përdoret si për aksesimin e materialeve të ndryshme, ashtu edhe për përgatitjen e detyrave, prezantimeve dhe punimeve të diplomave.
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Personeli akademik dhe studentët e këtij programi studimi, përdorin platformën Microsoft Teams. Përdorimi i kësaj platforme ka gjetur zbatim të gjerë, kryesisht gjatë pandemisë Covid-19 (Evidencë 4.4_Manuali i Përdorimit të Platformës Temas; Evidencë 4.4.a Print screen klase Teams). Edhe pas rifillimit të zhvillimit të proceseve mësimore në auditorë, përveç komunikimit të drejtpërdrejt, komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve midis personelit akademik dhe studentëve, zhvillohet kryesisht nëpërmjet adresave zyrtare të e-mailit, sikurse dhe klasat në platformën Microsoft Teams.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të	Institucioni informon studentët mbi rregullat e lidhura me procesin e diplomimit, si për rastet kur ky detyrim final do të realizohet nëpërmjet punimit të diplomës,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	ashtu edhe në ato raste ku studentët do i nënshtrohen provimit të diplomimit (Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës). Për secilin student që do të zhvillojë një temë diplome, Departamenti cakton një pedagog udhëheqës, i cili orienton dhe mbështet studentin që nga momenti i përzgjedhjes së temës e deri në mbrojtjen e saj.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	Njësi përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, bashkëpunon me njësi të tjera në nivel institucional, të tilla si NJSBC dhe Zyra për Zhvillimin e Kurrikulave, në kuadër të përmirësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë NJSBC-ja është e angazhuar me një sërë metodash vlerësuese gjatë gjithë vitit, për secilin program studimi. (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik; Evidencë 6.6_Rregullore për Mbarëvajtjen e Kurrikulave dhe Procesit Mësimor; Evidencë 6.8_Rregullore e NJSBC).
Kriteri 2. Njësi kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personelit akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies (Evidencë 1.4_Statuti i AU; Evidencë 1.1_Rregullorja e Departamentit), i cili bashkëpunon me strukturat e tjera institucionale, sikurse dhe me personelin akademik dhe studentët e programit të studimit (Evidencë 3.3_Pyetësorët; Evidencë 3.4_Fokus-Grupe). Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion, u konstatua ekzistenca e një komunikimi të vazhdueshëm midis drejtuesit të departamentit, personelit akademik dhe studentëve, lidhur me cilësinë e mësimdhënies dhe aktiviteteve të tjera të jetës studentore. Cilësia në mësimdhënie është temë frekvente gjatë mbledhje departamentale.
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Liria akademike (e konstatuar gjatë takimeve me personelin akademik), angazhimi i një personeli me kualifikime dhe formim të përshtatshëm në disiplinat që mbulojnë, sikurse dhe zhvillimi i trajnimeve, janë tregues se njësitë përgjegjëse mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies (Evidencë 2.2_CV Personeli Akademik; Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik).
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Organizimi i trajnimeve për personelin akademik (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik), organizimi i konferencave dhe mundësia për të botuar në revistën shkencore të universitetit, pa pagesë, janë tregues të mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik. Gjatë takimeve në institucion, përfaqësuesit deklaruan se ekziston një fond i veçantë në buxhetin vjetor, i cili i dedikohet mbështetjes së personelit akademik për kualifikim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor.
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Në kuadër të përmirësimin të aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja, njësitë përgjegjëse organizojnë trajnime të vazhdueshme për personelin akademik. Ndër trajnimet kryesore të zhvilluara nga Institucioni, mund të përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • “Vlerësimi psikosocial dhe Motivimi i studentëve për të rritur vetëfikasitetin e të nxënit” • “Shkëmbim eksperience midis stafit akademik mbi organizimin e një ore mësimi”

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<ul style="list-style-type: none"> • “Përdorimi i google classroom” (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik). 		
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit, për komponentët ku ata janë të angazhuar si titullarë apo si asistentë, dhe është i angazhuar për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimit të metodave inovative, të cilat reflektohen në syllabusin e lëndës, por edhe në feedback-un që merret nga mekanizmat e monitorimit të cilësisë (Evidencë 3.3_Pyetësorët; Evidencë 3.4_Fokus-Grupe; Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve).		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Gjatë vizitës në institucion, nga ana e përfaqësuesve u deklarua se implementimi i metodave të reja dhe rezultatet e tyre, janë objekt i diskutimeve në mbledhjet e Departamentit, por nuk evidentohet ndonjë formë e strukturuar dhe periodike për rezultatet e implementimit të këtyre metodave.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5			
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.			
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit), sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Studenti kur fillon vitin akademik, në orën e parë të secilës lëndë njihet em të gjithë elementet e saj, përfshirë edhe vlerësimin.		
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuset e lëndëve (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara format e kontrollit të dijeve, të cilat bazuar në tipologjinë e lëndëve, ndahen në katër kategori kryesore: në lëndët që kanë vetëm leksione dhe seminare, lëndë që përveç leksioneve dhe seminareve, kanë edhe laboratorë, në lëndë që kanë leksione/seminare, laboratorë dhe detyra kursi, dhe lëndë që kanë leksione/seminare dhe detyra kursi.		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme, në bazë të katër kategorive të mësipërme, dhe përfshijnë: pjesëmarrje dhe aktivizim në seminar, dorëzimi i detyrave, vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë, provim i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar (Evidencë 4.5_Syllabuset e lëndëve).		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Procesi i vlerësimit realizohet gjatë gjithë vitit akademik (semestrave), i cili konstatohet nga vlerësimi për dy provime (i ndërmjetëm dhe përfundimtar), pjesëmarrjes dhe aktivizimit në seminar, detyrat e kursit dhe pjesëmarrjes në laboratorë, si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive – 10% • Plotësimi i detyrimeve (ushtrime, detyra, projekte) – 10% • Testimet gjatë vitit – 20% • Provimi përfundimtar – 60%. <p>(Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit, Neni 25 Kontrolli ose Vlerësimi i dijes; Evidencë 4.5_Syllabusët e lëndëve).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Nuk evidentohen sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. I vetmi element, i cili mund të lidhet në mënyrë të tërthortë me këtë kriter, është procesi i sekretimit të provimeve (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Testimi i njohurive zhvillohet si rregull vetëm nga titullari i lëndës (së bashku me asistentin nëse ka të tillë). Vlerësimi i provimeve të lëndëve me komision, parashikohet vetëm për raste të veçanta (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Provimet me shkrim, i nënshtrohen procesit të sekretimit dhe gjatë zhvillimit të provimit, klasat monitorohen nga Komisioni i survejimit, i cili përbëhet nga dy pedagogë monitorues, të cilët janë përgjegjës për zbatimin e rregullave për zhvillimin e provimeve (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjatë vizitave në institucion, u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. Ata njihen me rezultatet dhe me fletët e provimit, për tu qartësuar për vlerësimin e tyre me detaje.</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, janë të përcaktuara rregullat për zhvillimin e procesit të provimeve (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Procesi i sekretimit, sikurse dhe monitorimi i sallës gjatë zhvillimit të provimeve, janë mekanizma të cilat ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Personeli akademik ka një afat 7 ditor për vlerësimin dhe paraqitjen e rezultateve pranë sekretarisë mësimore, e cila njih studentët me këto rezultate (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit). Studentët mund të informohen për rezultatet edhe nëpërmjet sekretarisë online.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit, parashikohet e drejta e studentëve për t'u njohur me tezën e provimit dhe të paraqesë një kërkesë me shkrim për rivlerësim. Nga diskutimet me studentët, në këtë program studimi nuk kishte pasur raste që kalonin më tej se diskutimi me pedagogun e lëndës. (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).</p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e</p>	<p>Studenti ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të degës përkatëse, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Dekani i Fakultetit ngre një komision ad hoc, në përbërje të të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi</p>

ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore. Vendimi i bashkëlidhet proces-verbalit të provimit. (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit, e kombinuar me mënyrën e zhvillimit të saj, garanton thellimin e njohurive dhe aftësi profesionale (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor). Viti i parë akademik nis me lëndë të përgjithshme, për të shkuar gradualisht në semestrat dhe vitet në vijim, drejtë lëndëve karakterizuese të programit, dhe deri tek praktika profesionale dhe diplomimi.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politico-Administrative”, përmban lëndë për zhvillimin e aftësive në fushën e komunikimit (Komunikim Politik) dhe gjuhë të huaj. Në program nuk ka lëndë të dedikuara zhvillimit të aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në përfundim të çdo lënde, personeli akademik dorëzon pranë Departamentit një raport, në të cilin analizohen elementët e nevojshëm për realizimin e procesit mësimor (Evidencë 3.2.a_Raporti i Vetëvlerësimit të Personelit Akademik).
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Gjatë takimeve të zhvilluara si me personelin akademik ashtu edhe me studentët, u konstatua se në përfundim të lëndëve/moduleve, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të trajtuara në atë lëndë/modul dhe orienton studentët për implementimin e tyre.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Në institucion zhvillohen leksione të hapura dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare, të cilat lidhen si me zhvillimet e fundit në fushën e programit të studimit, ashtu edhe në fusha të tjera interdisiplinare apo me karakter praktik dhe aplikativ. Ndër aktivitetet kryesore të organizuara nga institucioni, të cilat lidhen me përmbushjen e këtij kriteri, vlen të përmendim: <ul style="list-style-type: none"> • “Lidership për Shekullin e XXI (Dhjetor 2021 – Mars 2022). • Leksioni i hapur “Roli i Austrisë në Bashkimin Europian”, me pjesëmarrjen e ambasadorit austriak në Tiranë. • Leksioni i hapur “Markets and Morality”. • Leksion i hapur “Dekriminalizimi – Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur”. • Leksion i hapur “(Jo)Stabiliteti Rajonal dhe impakti në interesat e Shqipërisë dhe Shqiptarëve”. (Evidencë 5.7_Aktivitete shkencore dhe ekstrakurrikulare).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë	Në tërësi, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në lëndë të ndryshme të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale.	programit të studimit. Për vetë natyrën e programit të studimit, fushës së tij, nuk gjenden shumë element të lidhur me mundësi për të zhvilluar njohuri të marra në laboratorë.		
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në këtë mënyrë, studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e shkencave politiko-administrative.		
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Zhvillimi i dy lëndëve si Lexim Kritik dhe Shkrim Akademik dhe Metodat e Kërkimit Shkencor, pajisin studentët me aftësi për të kryer kërkim shkencor të nivelit që përkon me nivelin e një programi studimi të ciklit të parë (Evidencë 1.5_Kurrikula; Evidencë Tabela 9 & 10_Plani Mësimor). Organizimi i detyrave të kursit, sikurse dhe puna në grup apo individuale për seminarët në lëndë të ndryshme, janë tregues të krijimit të një klime të përshtatshme për përmbushjen e këtij kriteri. Ky element u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit.		
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Organizimi i konferencave, trajnimeve dhe leksioneve të hapura, ku studentët janë të ftuar të marrin pjesë, sikurse dhe organizimi i Konferencës Studentore, aktivitete të cilat organizohen dhe financohen nga institucioni, janë tregues të mbështetjes së studentëve si në aspektin organizativ ashtu edhe financiar (Evidencë 5.7_Aktivitete shkencore dhe ekstrakurrikulare).		
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Pavarësisht se institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe po punon për shtimin e tyre, konstatohet se numri i mobiliteteve si nga stafi akademik ashtu edhe studentët, është shumë i ulët. Në një kohë që ndërkombëtarizimi është si prioritet në nivel kombëtar, ashtu edhe për IAL-të, konstatohet se ky kriter nuk përmbushet në nivel të kënaqshëm. <i>Institucioni rekomandohet duhet të punojë për shtimin e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në aktet e brendshme rregullatore, është përcaktuar procedura e posaçme për diplomimin, si për rastet e punimit të temës së diplomës, ashtu edhe provimit të diplomimit (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës). Këto dokumente dhe informacioni mbi këtë proces, u vihet në dispozicion studentëve, gjë e cila u konstatua gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Studentët asistohen si në aspektin e informimit të tyre lidhur me procesin e provimit final apo mbrojtjes së diplomës, ashtu edhe të përgatitjes për zhvillimin e provimit apo mbikëqyrjen e punimit të diplomës (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës).


Adresa: "Ruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në rregulloren përkatëse, përcaktohen kriteret e studentëve që i nënshtrohen provimit final (mesatarja) sikurse dhe lëndët mbi të cilat do të mbështetet kontrolli i njohurive (Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit). Për këtë program studimi, provimi do të mbështetet në lëndët:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkenca Politike • Administrim Publik • Elementet e Qeverisjes dhe Procese Zgjedhore • Filozofia Politike • Marrëdhëniet Ndërkombëtare • Historia e Shtetit Shqiptar dhe Sistemet Politike dhe Administrative. 		
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Për studentët të cilët do i nënshtrohen provimit të diplomimit, përpara zhvillimit të provimit, organizohen orë konsultimi në auditor me studentët diplomantë. Ndërsa për studentët të cilët do zhvillojnë punim diplome, orientimi dhe ndihma nis që me caktimin e temave dhe drejtuesve, e deri në momentin e finalizimit të këtij procesi (Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës).</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Personeli akademik por edhe ai administrativ (Zyra e IT), asistojnë studentët në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Ky proces facilitohet edhe nga marrëveshjet që institucioni ka lidhur me partnerë të tjerë (Evidencë 1.6_Marrëveshje Bashkëpunimi).</p>		
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në të gjithë procesin, nga përcaktimi i temës e deri në përfundimin e saj. Teza quhet e përfunduar vetëm në momentin kur miratohet nga udhëheqësi shkencor, i cili përgatit edhe një relacion vlerësimi (Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës).</p>		
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Provimi i diplomimit dhe punimi i diplomës vlerësohen me pikë, nga 0 deri në 100, ku vlera minimale për kalim është 41 pikë (Evidencë 1.1.a_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 2.6_Rregullore e Provimit të Diplomimit; Evidencë 2.7_Udhëzues i Përgatitjes së Temës së Diplomës).</p>		
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në programin Bachelor në "Shkenca Politiko-Administrative", studentët pajisen me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin (Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme; Evidencë Extra 1_Model Diplome; Evidencë Extra 2_Model listë notash dhe Supplement).</p>		
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studentit merr një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sikurse dhe plan programet e plota sipas kërkesës së tij.</p>		
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.</p>	<p>Sekretaria Mësimore, menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre (Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme).</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	Të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, mblidhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Këto të dhëna përfshijnë personelin akademik (PAE dhe PAK), sikurse dhe personelin administrativ. Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dosje, konstatohet se kjo Zyrë administron vetëm dokumentacionin bazë (kontratë, kualifikime, CV, etj.), por jo të dhëna mbi vlerësimet e personelit akademik dhe administrativ, apo për ngarkesën e tyre të orëve mësimore (për personelin akademik). <i>Zyra e Burimeve Njerëzore në mendimin tonë duhet të administrojë edhe dokumentacionin e lidhur me ngarkesën mësimore të personelit akademik, por edhe raporte vlerësimi për personelin akademik dhe administrativ.</i>			
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik në përputhje me bazën ligjore në fuqi, sikurse dhe me aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1.4_Statuti i AU; Evidencë 2.1_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; Evidencë 4.1_Plotësimi i Vendeve Vakante).			
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Procedura dhe kriteret e posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1.4_Statuti i AU; Evidencë 2.1_Rregullore e Fakultetit të Shkencave Shoqërore; Evidencë 4.1_Plotësimi i Vendeve Vakante) dhe bëhen publike në faqen zyrtare të universitetit.			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura nga evidentimi i vakancave e deri tek lidhja e kontratës dhe periudha e provës, janë të specifikuar në aktet e brendshme rregullatore. Nga shqyrtimi i DVV të vënë në dispozicion nga institucioni, por edhe nga takimi i zhvilluar me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, konstatohet se nuk ka një sistem të vlerësimit të kandidaturave, nga ana e Komisionit. <i>Rekomandojmë institucionin të hartojë dhe implementojë një sistem vlerësimi me pikë të kandidaturave, gjatë procesit të rekrutimit të personelit të ri.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve								
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë, sikurse dhe takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, konstatohet se institucioni është i angazhuar për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Krijimi i mjedisit dhe kushteve nis nga infrastruktura fizike në dispozicion (zyrat, pajisjet IT, kushtet e auditorëve ku zhvillohen procese akademike) (Evidencë Tabela 16_Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë; Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës), për të vijuar me një kuadër të brendshëm rregullator, publik dhe transparent, të të drejtave dhe detyrimeve të personelit (Evidencë 1.4_Statuti AU; Evidencë 1.3_Rregullore e Përgjithshme e AU; Evidencë 4.2.a.b_Kontrata PAE/PAK), e deri tek mbështetja institucionale për zhvillimin e personelit (Evidencë 1.2_Plani strategjik institucional; Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik).								
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Mbështetja e institucionit për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin profesional të personelit akademik, përbën një ndër prioritetet e institucionit (Evidencë 1.2_Plani Strategjik Institucional).								
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Organizimi i trajnimeve për personelin akademik (Evidencë 3.1.a_Agjenda e Trajnimeve të Personelit Akademik), organizimi i konferencave dhe mundësia për të botuar në revistën shkencore të universitetit, pa pagesë, janë tregues të mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik. Gjatë takimeve në institucion, përfaqësuesit deklaruan se ekziston një fond i veçantë në buxhetin vjetor, i cili i dedikohet mbështetjes së personelit akademik për kualifikim të vazhdueshëm në fushën e kërkimit shkencor.								
Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Nisur nga numri, cilësia dhe kualifikimet e burimeve njerëzore të angazhuar në këtë program studimi, konstatohet se ky kriter plotësohet. Angazhimi i një personeli prej 16 personash në vitin akademik 2021-2022, prej të cilëve 4 kategoria "Profesor", 9 kategoria "Lektor" dhe 3 kategoria "Asistent Lektor", të cilët përveç kualifikimeve akademike kanë edhe eksperiencë dhe ekspertize të konsiderueshme në lëndët ku ata janë të angazhuar, të mbështetur dhe nga strukturat administrative, dëshmojnë se institucioni ka mundur një angazhim optimal të burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të këtij programi studimi. (Evidencë Tabela 6_Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Evidencë Tabela 7_Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik, sipas kualifikimit; Evidencë 2.2_CV Personeli Akademik).								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën	Gjatë vizitës në institucion dhe vëzhgimit të infrastrukturës në funksion të programit të studimit, u konstatua se procesi mësimor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve dhe në përputhje me fushën e programit të studimit (Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të programit të studimit, ka një sipërfaqe totale prej rreth 4618 m², ku ndër mjedise kryesore mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 19 salla për leksione/seminare, me sipërfaqe 1511 m². • 1 sallë për aktivitete promovuese, me sipërfaqe 245 m². • 1 laborator informatike - me sipërfaqe 35 m². • 1 sallë biblioteke - me sipërfaqe 249 m². • 1 mjedis për fotokopje, me sipërfaqe 7 m². • 1 zyrë informacioni për studentët, me sipërfaqe 6 m². • 2 mjedise shlodhëse si kafeteri/fast-food, me sipërfaqe 567 m². • 6 nyje hidrosanitare, me sipërfaqe 106 m². <p>(Evidencë Tabela 16_Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë; Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).</p> <p>GVJ konstaton se këto mjedise, të cilat janë edhe të pajisura me infrastrukturën IT (kompjuter, projektor, sistem audio), janë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në përputhje me natyrën e programit në fushën e shkencave politiko-administrative.</p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore janë të pajisura me pajisjet e nevojshme elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, dhe konsiderohen të përshtatshme në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit në fushën e shkencave politiko-administrative. Sallat janë të pajisura me kompjuter, video-projektorë, internet, sistem fonie dhe sistem kondicionimi. (Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratori i IT, me një kapacitet prej 30 PC, konsiderohet i përshtatshëm për plotësimin e kërkesave të programit të studimit, nisur nga vetë natyra e këtij programi. Laboratori përdoret për të aksesuar informacion, për të përgatitur prezantime dhe detyra kursi, etj. (Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i IT është i pajisur me programet e paketës Microsoft Office, të cilat mund të përdoren nga studentët e këtij programi studimi. Për vetë natyrën e këtij programi, paketa Office është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe vëzhgimi i infrastrukturës, konstatohet se institucioni garanton kapacitetet dhe mjediset e nevojshme, për zhvillimin e veprimtarive praktike (të cilat lidhen kryesisht me përgatitje prezantimesh, detyra kursi, etj.). (Evidencë 1.9_Planimetria e Godinës).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka mësimore vlerësohet si e përshtatshme, si në aspektin e kapaciteteve akomoduese (poste leximi dhe kompjuter) ashtu edhe në aspektin e fondit fizik të literaturës në dispozicion. Këto elemente garantojnë mundësinë e shfrytëzimit të bibliotekës në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Fondi i bibliotekës në dispozicion të fushës studimore të këtij programi studimi, vlerësohet si i përshtatshëm (Evidencë 4.3_Lista e Literaturës së Bibliotekës). Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>Sikurse është analizuar dhe në kriterin përkatës lidhur me update-imin e literaturës së 5 viteve të fundit, Rekomandojmë Institucionin që të marrë masa për sigurimin e literaturës së 5 viteve të fundit, për lëndët kryesore të programit të studimit, në të cilat nuk përmbushet ky kriter.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e bibliotekës janë edhe bibliotekat online, të tilla si EBSCO, ERIC dhe Getty të cilat mund të aksesohen nga studentët në ambientet e bibliotekës (Evidencë Tabela 17_ Të dhëna të plota për platformat online/biblioteka online). Aksesi është i barabartë e pa pagesë për studentët, konstatuar edhe gjatë takimit të GVJ me studentët e këtij programi studimi.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Në ambientet e bibliotekës gjenden kompjuter, të cilët janë të pajisur me paketën Microsoft Office, e cila mund të përdoret nga studentët e këtij programi studimi, pa kufizime për të gjithë studentët e interesuar. Ata zakonisht e përdorin atë për plotësimin e detyrave dhe esve apo përgatitjen e ndonjë prezantimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Shtimi i zërave të bibliotekës është një proces periodik, i cili facilitohet edhe nga fakti që institucioni ka një shtëpi botuese. Gjatë takimeve të zhvilluara me drejtuesin e Departamentit por edhe me personelin akademik, u deklarua se shtimi i zërave në bibliotekë, për literaturën që lidhet me programin e studimit, inicohet nga personeli akademik me një kërkesë që i drejtohet Drejtuesit të Departamentit, i cili e përcjell tek Administratori/Shtëpia Botuese. Gjithashtu, nëpërmjet analizës semestrale/vjetore të Departamentit, nëpërmjet bashkëpunimit midis Koordinatorit të Programit dhe Drejtuesit të Departamentit, evidentohen edhe rastet kur është e nevojshme të shtohet fondi i literaturës në bibliotekë. Totali i teksteve në fondin e bibliotekës deri në vitin akademik 2020-2021 ka qenë 215, prej të cilave 11 tekste hyrje të reja në atë vit akademik. (Evidencë 1.1_Rregullorja e Departamentit; Evidencë 3.2.c_ Raport Vjetor Departamenti).</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve, në orarin 08:00-16:00, orar i cili është i shpallur në mjediset e institucionit dhe në hyrje të bibliotekës. Në sezonin e provimeve, biblioteka funksionon edhe përtej këtij orari. Nga vizita në mjediset e bibliotekës dhe zhvillimit të takimit me punonjësen e bibliotekës, konstatohet se fondi i librave fizik mund të përdoret vetëm brenda ambienteve të bibliotekës.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohen të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit, administrohen nga Sekretaria Mësimore, Kryesekretari si dhe Administratori i Përgjithshëm. Në këtë databazë, administrohen të dhënat e studentëve nga fillimi i studimeve, e deri në përfundimin e tyre.</p> <p><i>Rekomandohet që me qëllim dixhitalizimin e të dhënave dhe aksesin efikas në informacion, institucioni duhet të marrë masa për vendosjen e një Sistemi Menaxhimi elektronik të të dhënave të studentëve por edhe personelit akademik dhe administrativ.</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të të dhënave të personelit, administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Zyra e Burimeve Njerëzore administrojnë të dhënat e stafit (dokumentacionin) mbi kualifikimet dhe aktivitetet e tyre, kontratat e punës, CV dhe dokumentacionin shoqëruar (Evidencë 4.2.a_Kontrata PAE; Evidencë 4.2.b_Kontrata PAK; 4.2.c_Kontrata Personel Administrativ).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Dokumentacioni i stafit dhe studentëve është i aksesueshëm nga sistemi i brendshëm i institucionit. Institucioni ka në përdorim sekretarinë online, sistemi Pitagora i RASH (Evidencë Tabela 17_Të dhëna të plota për platformat online). Dokumentacioni fizik i studentëve administrohet nga Sekretaria Mësimore, ndërsa të dhënat e personelit, administrohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Departamenti. Zyra e Burimeve Njerëzore administrojnë të dhënat e stafit (dokumentacionin) mbi kualifikimet dhe aktivitetet e tyre, kontratat e punës, CV dhe dokumentacionin shoqëruar (Evidencë 4.2.a_Kontrata PAE; Evidencë 4.2.b_Kontrata PAK; 4.2.c_Kontrata Personel Administrativ). Dokumentacioni mund të aksesohet nëpërmjet intranetit, por sikurse është evidentuar edhe në Kriterin 1 më lart, Institucioni nuk ka një sistem elektronik të menaxhimit të informacionit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni është mbështetur në përdorimin e platformës Microsoft Teams, për zhvillimin e procesit akademik gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit kryhet edhe nëpërmjet adresave zyrtare të e-mailit. Gjithsesi, vendosja në funksionim e platformave të integruara, është një aspekt i cili duhet të merret në konsideratë nga institucioni, sipas rekomandimit të shprehur në Kriterin 1, më lart.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Përveç disa faciliteteve që mundësohen nga përdorimi i platformës Microsoft Teams, mungesa e platformave të integruara në një sistem menaxhimi elektronik, bën që institucioni të mos jetë në gjendje të garantojë përmbushjen e këtij kriteri.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacionet e lidhura me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet të ndryshme, publikohen në faqen e internetit të institucionit (www.albanianuniversity.edu.al), në gjuhën shqipe dhe angleze. Aktivitetet publikohen edhe në rrjetet sociale të institucionit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raporti financiar i kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit, hartohet dhe disponohet nga Zyra e Financës. Bazuar në të dhënat e përcjella nga institucioni, burimi i vetëm i të ardhurave janë të ardhurat nga tarifat e shkollimit (Evidencë Tabelat përmbledhëse 18_Të ardhurat dhe financimet).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Plani i financimit përmban zërat e ndryshëm, si kostot dhe shpenzimet ashtu edhe të ardhurat. Të gjithë zërat bëhen bazuar në nevojat e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, nga personeli akademik, tek infrastruktura, mbështetja financiare për kërkimin shkencor, etj. (Evidencë Tabelat përmbledhëse 18_Të ardhurat dhe financimet).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Institucioni kryen auditim të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, i cili bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik, sipas standardeve të kontabilitetit. Bazuar në Raportin e Audituesve të Pavarur, pasqyrat financiare të Shoqërisë "UFO" sh.p.k, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar në datën 31 Dhjetor 2020, Pasqyrën e të ardhurave Gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e Ndryshimeve në Kapital dhe Pasqyrën e Flukseve të Parasë, në opinionin e tyre Pasqyrat Financiare paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale (Evidencë 4.6_Raport Auditimi).
Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit. Rektori përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit (Evidencë 1.4_Statuti i AU).
Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e institucionit, konstatohet se institucioni garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit (Evidencë Tabelat përmbledhëse 18_Të ardhurat dhe financimet; Evidencë 4.6_Raport Auditimi).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Programi i studimit është ndërtuar dhe bazuar në Rregulloren e vet, Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e FSHSH, Rregulloren e Përgjithshme dhe Statutin e Universitetit, si dhe në Ligjin e Arsimit të Lartë. Në Rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit cilësohet se “Departamenti përgjigjet për programet e studimit” gjithashtu në këtë dokument përcaktohen qartë të gjitha njësitet me rolet dhe përgjegjësitë e tyre për realizimin dhe mbarëvajtjen e plotë të këtij programi studimi. Kjo Rregullore sëbashku me dokumentet e tjera të Universitetit Privat “Albanian University” shërbejnë si udhërrëfyes për stafin akademik e administrative si dhe studentët e këtij programi studimi për njohjen e të drejtave dhe detyrimeve përgjatë të gjithë kohës së punës dhe studimit në këtë institucion. Në Rregulloren e Departamentit Kreu III “ Organizimi i studimeve në Departamentin e shkencave juridike dhe Politiko-Administrative ” apo në Kreun IV të Rregullores së FSHSH parashikohet mënyra e funksionimit të programeve të studimit. Gjithashtu institucioni në datën 25.06.2020 ka përditësuar E.5.1- “ Rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve ”. Ky dokument i bënë me dije studentëve këto procedura. Gjithashtu nga takimi që GVJ pati me strukturat përgjegjëse që mbajnë kontakt me studentët në këtë institucion u pa se institucioni ka një mirëorganizimin dhe vëmendje përmes strukturave të ngritura për studentët që nga hyrja e deri në dalje. Procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student të programit të studimit. (Evidencë: E.1.1 -Rregullorja e Departamentit; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit; E.2.1-Rregullore e FSHSH; E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU; E.1.4 Statuti i Albanian University; E.5.1-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve)
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Universiteti Privat “Albanian University” bazuar në Udhëzimin e MAS realizon procedurat e regjistrimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultojnë se procedurat në hyrje e deri në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për student të programit të studimit. Krahas dokumenteve të tjera institucioni ka një “ Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve ” (Evidenca E.5.1) ku për të gjitha ciklet e studimit jepën procedurat e regjistrimit, cilat janë kriteret apo procedura për transferimin e programit të studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në dokumentacionin e shqyrtuar si E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU; E.1.4 Statuti i Albanian University; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit (Kreu III, nga Neni 10 deri tek neni 13); E.5.1-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve dhe dokumenta të tjerë, vërehet që kriteret dhe procedurat e pranimit dhe të përzgjedhjes janë të kuptueshme dhe të aksesueshme. I gjithë informacioni që lidhet me të gjithë procedurën që nga pranimi, përzgjedhja e studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit (E.5.5-Manuali i Studentit) të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë informacione lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Institucioni përmes Zyrës së “Transferimit dhe Ekuivalentimit të studimeve” i jep mundësin e informimit çdo student. Gjithashtu në fillim të vitit akademik institucioni realizon javën orientuese për njohjen e studentëve me mënyrën sesi funksionon universiteti. (Evidence: E.5.6-Agenda e Javës Orientuese; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>												
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, Universiteti Privat “Albanian University” realizon pranimin e maturantëve që kanë aplikuar përmes portalit të maturës shtetërore për këtë program studimi. Institucioni, krahas kriterit të notës mesatare mbi 6 të vendosur nga MAS, ka aplikuar kritere shtese të pikëzimit që lidhen me lëndët e veçanta si histori, qytetari filozofi, sociologji apo psikologji. (Evidence: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>												
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Në faqën zyrtare të Universitetit Privat “Albanian University” https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/ gjendet i gjithë informacioni që lidhet me kriteret e pranimit në këtë Universitet. Institucioni, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr 436 dt 3.6.2020 Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare 2020-2021, 2021-2022 dhe 2022-2023, ka vendosur si kritere: Kriter i parë pranimi në “Albanian Univeristy” është përfundimi me sukses i arsimit të mesëm. Gjithashtu janë publike dhe të aksesueshme kriteret e përgjithshme dhe specifike që bëjnë të mundur renditjen e aplikantëve në “Albanian Univeristy” si mesatarja e përgjithshme me peshë 70% dhe mesatarja e lëndëve sipas programeve të studimit me peshën 30%. Tabela e mëposhtme është shkëputur nga faqa zyrtare e universitetit dhe tregon sesi është trajtuar kriteri specifik sipas grup-lëndëve të përzgjedhura. E drejta e studentëve të huaj për tu regjistruar në programet e studimit të këtij universiteti është e parashikuar në nenin 49 të Rregullores së Përgjithshme të AU thuhet se: “Në universitet pranohen për të ndjekur studime shtetas shqiptar ose të huaj”.</p> <table border="1" data-bbox="692 1406 1289 1868"> <tr> <td rowspan="2">Fakulteti:</td> <td colspan="2">Mesatarja e përgjithshme: 70%</td> </tr> <tr> <td colspan="2">Mesatarja e lëndëve: 30%</td> </tr> <tr> <td rowspan="3">Shkenca Politike – administrative</td> <td>Histori</td> <td>15%</td> </tr> <tr> <td>Qytetari</td> <td>5%</td> </tr> <tr> <td>Sociologji, Psikologji, Filozofi</td> <td>10%</td> </tr> </table>	Fakulteti:	Mesatarja e përgjithshme: 70%		Mesatarja e lëndëve: 30%		Shkenca Politike – administrative	Histori	15%	Qytetari	5%	Sociologji, Psikologji, Filozofi	10%
Fakulteti:	Mesatarja e përgjithshme: 70%												
	Mesatarja e lëndëve: 30%												
Shkenca Politike – administrative	Histori	15%											
	Qytetari	5%											
	Sociologji, Psikologji, Filozofi	10%											



<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka disa forma të informimit dhe orientimit mbi kërkesat e kriteret që ka programi i studimit. Institucioni organizon fushata informuese me maturantët për ti informuar ata mbi ofertën akademike të institucionit. Këto takime bëhen të mundura nga bashkëpunimi me DRPA dhe ZVA. Gjithashtu në faqen zyrtare të institucionit gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm që lidhet me kërkesat e kriterëve përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. (Evidencë: https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të shqyruar GVJ konsatoi se që në hyrje të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen vazhdimisht mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si; kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifat, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtari akademike, kulturore, njoftime, sikurse dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p> <p>Në dokumente të tilla si: Rregullore e Përgjithshme neni 37 “Afati i studimeve” pika 4 sqarohet se “Studenti lejohet të vijojë vitin pasardhës kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës...”. Në Rregulloren e Programit të studimit, neni 12 “Kohëzbatja e studimeve” sqarohet dhe me tej kalimi nga një vit akademik në tjetrin. Studenti mund të informohet pranë sekretarisë mësimore mbi përparimin e tij akademik. (Evidencë: E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Procedura për njohjen e kualifikimeve ose studimeve të pjesshme është e përcaktuar në njëserë dokumentash që institucioni ka. Studentet informohen në lidhje me njohjen e kualifikimeve të tyre të mëparshme ose të kryera heret në kohë, sikurse pranohen edhe transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit. E gjithë kjo procedurë është e rregulluar me dokumentacion dhe parashikohet në dokumentin E.5.1-Rregullore e Regjistrimeve dhe Transferimeve ku sqarohet procedura që institucioni ndjek në lidhje me njohjen e studimeve.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Informimi i studentëve lidhur me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve realizohet në disa forma:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Npërmjet Rregullores të programit të studimit neni 25 “Kontrolli dhe vlerësimi i dijes”, 2. Npërmjet dokumentit E.5.5-Manuali i Studentit fq.5 3. Npërmjet syllabuseve lëndore që jepen nga personeli akademik në orën e parë të fillimit të çdo lënde (E.4.5-Syllabuset e Lëndëve) 4. Npërmjet personelit akademik në fillim të çdo semestri <p>Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni krahas dokumenteve të tjera ka dy dokumente të hartuara specifikisht për procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit. Institucioni organizon seanca informimi mbi punimin e diplomës. Ka dhe ndjek një procedurë të mirë përcaktuar në dokumentin E.2.6-Rregullorja e Provimit të Diplomimit ; E.2.7-Udhëzuesi i përgatitjes së Temës së Diplomës		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të viti akademik institucioni realizon takime informuese me maturantë duke i informuar mbi programet e studimit që ky universitet ofron. Institucioni realizon dhe shpërndan Broshura me informacione në lidhje me programet e studimit të ciklit të parë bachelor (Evidencë Extra.6-Broshura 2022-2023). Institucioni organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Në fillim të vitit akademik 2021-2022 është organizuar “Java e orientimit”, përkatësisht në datat 18-20 tetor 2021. (Evidencë E.5.6-Agjenda e Javës Orientuese)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Institucioni ka disa forma të informimit të studentëve përsa i takon njohjes me strukturën dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Në dokumente të tilla si E.2.1-Rregullore e FSHSH apo më specifikisht në dokumentin “ E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit ” gjendet informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Gjithashtu, studenti mund të informohet përmes faqes zyrtare online të institucionit, përmes zyrës së kujdesit të studentit, nga stafi akademik, kontratës që nënshkruan me institucionin etj. Këto struktura dhe dokumente u mundësojnë studentëve informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Mundësitë e informimit fizik dhe jo vetëm merren në institucion pranë disa zyrave apo njërive që ofrojnë informacione për çdo program të detajuar që interesohet studenti. Studentët pajisen me një dosje që përmban të gjithë informacionin që lidhet me programin e tyre të studimit. Në dokumente të tilla si Statuti i Albanian University (neni 46 “Statusi Student”, neni 47 “Të drejtat e studentëve”, neni 48 “Detyrimet e Studentit”, apo në Rregulloren e përgjithshme të AU si dhe në Rregulloren e Programit të studimit janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet që i takojnë studentit. Në Statut neni 46 pika 1 përcakton se: “Një person fiton statusin e studentit me regjistrimin e tij në AU...”. Që në momentin e regjistrimit, studenti gëzon të gjitha të drejtat e studentit. Ai pajiset me informacionin e duhur që lidhet me programin e studimit që përmban lëndët dhe modulet e tij. Institucioni siguron akses dhe informacion për studentët në lidhje me elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes ëeb-it, zyrave të institucionit dhe stafit akademik që realizon programin. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit)
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit,	Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj studentëve si dhe Zyra karrierës dhe Alumnit janë strukturat që realizojnë procesin e informimit dhe këshillimit të studentëve gjatë dhe pas diplomimit. Struktura përkatëse ka përgatitur një

Adresa: “Ruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	dokument të titulluar “Udhëzues për zhvillimin e karrierës” për të asistuar studentët në këtë proces (Evidencë E.5.4-Udhëzues për zhvillimin e karrieres).		
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vizitës në institucion përmes takimeve të realizuara u informua mbi sistemin dhe strukturat përgjegjëse për informimin e studentëve mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Institucioni ka një sërë zyrash që janë në shërbim të studentëve. Gjithashtu, departamenti përmes sekretarisë, përgjegjësit të departamentit, koordinatorit të programit të studimit dhe stafit akademik mban komunikim dhe informon studentët për njoftimet që lidheshin me procesin mësimor. (Evidencë; Minuta Bsc Shkenca Politike adminsitratve)		
Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	Institucioni përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative realizon javën e parë orientuese si dhe orë të hapura për të njohur studentët me programin në tërësi. Kjo formë organizimi ndihmon për të shpërndarë informacionin por dhe për të sqaruar çdo paqartësi nga ana e studentëve përmes kontaktit direkt me stafin administrativ dhe akademik të departamentit. Gjithashtu, institucioni në faqen zyrtare por dhe përmes platformës TEAMS ofron informacion të arritshëm nga studentët edhe në distancë. Kjo gjë u konfirmua dhe nga takimi që GVJ pati me studentët e programit të studimit. (Evidencë: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022; E.4.4 -Manuali i Përdorimit të Platformës TEAMS; Minuta Bsc Shkenca Politike adminsitratve)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe vizitës së realizuar në institucion (takimi në sekretarinë mësimore) u pa se institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Më konkretisht, në Statutin e Albanian University Neni 50 “Dokumentacioni i procesit mësimor në funksion të studentëve” (pika 1 germa a; b dhe c) thuhet se: “Regjistrimi i studentëve bëhet në tre regjistra: Regjistri themeltar, Regjistri i arritjeve akademike dhe Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave”. Regjistrat plotësohen dhe ruhen bazuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Çdo student, në regjistrimin fillestar, pajiset me një numër unik matrikullimi, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, numër që e shoqëron studentin deri në marrjen e diplomës. Gjatë vizitës në institucion, në zyrën e sekretarisë mësimore, GVJ pa nga afër mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit që lidhet me statistikat vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në këtë program studimi. Rregjistrat e notave dhe ai themeltar ishin në kushte optimale, të plotësuara dhe të ruajtura në mënyrën e duhur nga stafi i sekretarisë. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; Vizita në institucion)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në vizitën e realizuar në institucion dhe takimin me sekretarinë mësimore, GVJ iu vunë në dispozicion të dhëna që lidheshin me numrin e studentëve të regjistruar në program, ata që ishin çregjistruar dhe ata që ishin me status aktiv. (Evidencë: Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në Universitetin Privat “Albanian University” pa se institucioni dispononte për çdo student dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i fillimit të programit dhe deri në përfundimin e tij. GVJ, në takimin e realizuar pranë sekretarisë mësimore, pa nga afër dosjen e një studenti, e cila përmbante të gjitha dokumentat e duhura si: diploma dhe lista e notave e noterizuar, kontrata, ID etj. Përzgjedhja e saj u bë në mënyrë rastësore. (Evidencë: Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Zyra përgjegjëse për administrimin dhe disponibilitetin e të dhënave është sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore bazuar në aktet rregullatore të institucionit dhe udhëzimeve të MAS mban të dhënat e studentëve në regjistrat përkatës për të dhënat akademike, të cilat gjenden njëkohësisht edhe në formën elektronike. Të gjitha rezultatet akademike të studentëve postohen në llogaritë individuale në sekretarinë online ku janë të aksesueshme në çdo kohë nga vetë studenti. Ky sistem/portali studentor përben një format elektronik të të dhënave që përdoren nga studentet dhe sekretaria me akses në çdo kohë si për të hedhur notat dhe rezultatet e provimeve ashtu dhe kontrolli i tyre nga ana e studentëve. Sistemi/portali shërben si burim të dhënash dhe informimi për studentët për vleresimet e tyre akademike. (Evidencë: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022; Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse si Zyra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me sekretarinë mësimore dhe departamentin realizojnë raporte analitike në mënyrë periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Krahas raporteve periodike që realizon departamenti për profilet e studimit që ofron, në nivel institucional prodhohen nga zyrat përkatëse raporte analitike për çdo profil studimi mbi shkallën e punësimit. Shkresa me nr. 1205 datë 14.12.2021 me titull “Raporti vjetor i statistikave të punësimit për vitin akademik 2020-2021” dëshmon për realizimin e këtyre raporteve. Për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 20 student në këtë profil studimi, nga këta student 2 prej tyre janë punësuar në përputhje me profilin e studimit ndërkohë 3 prej tyre janë të punësuar por jo sipas profilin të studimit. (ky dokument gjendet në Evidencën E.5.7- Aktivitetet shkencore dhe ekstrakurrikulare të studentëve)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Në dokumentet themelore të funksionimit të Albanian University janë të përcaktuara strukturat dhe numri i përfaqësimit të studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese. Bazuar në Statutin e AU neni 49 “Këshilli Studentor”, studentët kanë të drejtë të organizohen në Këshillin Studentor. Në bazë të Statutit, studentët përfshihen në disa struktura drejtuese me karakter mesimor-kërkimor dhe shërbime. Përfaqësuesit e studentëve përfshihen në struktura si: Senati Akademik (neni 19, pika 1, pika 6) përcaktohet se kryetari i Këshillit Studentor është dhe përfaqësues në SA. Përfaqësues të studentëve përfshihen dhe në struktura të tilla si: Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin; Komision për Vlerësimin Institucional; Komisionin për Kërkimin Shkëncor dhe Botimin. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Institucioni i garanton studentëve përfshirjen dhe të drejtën e përfaqësimit përmes të zgjedhurve të tyre në strukturat e përcaktuara. Statuti i Albanian University, në nenin 47, 48 dhe 49 përcakton dhe garanton të drejtat, detyrimet dhe formën e organizimit dhe përfaqësimit të studentëve. Studentët janë pjesë e komisioneve si për kurrikulat dhe mësimin apo dhe për vlerësimin institucional. Studentët në strukturat ku ata janë pjesë japin kontributin e tyre. Krahas detyrimeve të përcaktuara në Statut dhe Rreguloren, institucioni përdor disa forma të përfshirjes së studentëve dhe në vlerësimin e procesit akademik përmes pyetësorëve (E.3.3-Pyetesoret) dhe Fokus Grupeve (E.3.4-Fokus-Grupe). Rezultatet e këtyre instrumentave trajtohen në nivel të strukturave drejtuese. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; E.3.3-Pyetesoret 1; E.3.4-Fokus-Grupe; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ky program studimi ka pësuar ndryshime në masën 8.3% duke përmirësuar kurrikulën në bazë dhe të rekomandimeve të lëna nga akreditimi i mëparshëm (E.2.4-Procedura e rishikimit të kurrikules). Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe nga rezultatet, e analizës së Departamentit (E.3.2.c-Raport Vjetor Departamenti; E.3.2.b-Raport Semestral Departamenti), ngarkesa e programit të studimit (E.1.5-Kurrikulat) është strukturuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. Ka një ndarje të balancuar të ngarkesës mësimore në të 6 semestrat, gjë që i jep mundësi studentëve të mos jenë të mbingarkuar dhe të realizojnë një program të mirë koordinuar midis semestrave përgjatë gjithë kohës së realizimit të programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Nga shqyrtimi i procedurës së rishikimit të kurrikulës për programin e studimit bachelor “Shkenca Politiko-Administrative” në grupin e punës të ngritur për këtë qëllim nuk kishte përfaqësues nga studentët. Komisioni për rishikimin e kurrikulës përbëhej vetëm nga stafi akademik. Nuk ka evidencë që studentët të jenë angazhuar në ndonjë formë apo tu jënë marrë opinione për ndryshimet e realizuara. Gjithsesi studentët përmes plotësimit të pyetësorit 1 (evidenca 3.3) pyeten edhe mbi lëndët mësimore. Gjithashtu ata japin kontribut dhe përmes fokus-grupeve duke dhënë këndvështrimin e tyre për mënyrën sesi është dhe po zhvillohet programi i studimit. (Evidencë: E.2.4-Procedura e rishikimit të kurrikules E.3.3-Pyetesoret 1; E.3.4-Fokus-Grupe)</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Në dokumentin themelor si Rregullore e Përgjithshme e AU neni 57 pika b thuhet se studenti ka të drejtë që : “<i>të kërkoj vlerësim të drejtë dhe objektiv të dijeve dhe ecurisë së tij</i>”. Institucioni përmes dokumenteve dhe procedurave të miratuara i mundëson studentëve transparencë dhe barazi në marrjen e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në Rregulloren e Programit të Studimit neni 24 “Korrigjimi” përcaktohet procedura e realizimit të këtij procesi. Në pikën 3 të nenit 24 përcaktohet dhe e drejta e studentit për tu njohur me tezën dhe për të riparë apo kërkuar procesin e reklamimit me anë të një kërkesë me shkrim pranë sekretarisë mësimore brenda 48 orëve nga marrja e rezultetit.(Evidencë: E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU ; E.1.1.a-Rregullore e programit të studimit)</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me stafin akademik rezultoi se institucioni organizon në fillim të vitit akademik “Javën e orientimit”. Institucioni ka një Zyrë të Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit (ZKMS). Puna e kësaj zyre është e rregulluar në bazë të Rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit”. Kjo strukturë shërben si burim primar i informacionit dhe këshillave rreth mundësive të studimit dhe mbështetjes së studentëve. Anëtarët e stafit ndihmojnë studentët të përfshihen në jetën e universitare, i mësojnë studentët në lidhje me politikat e Universitetit. (Evidencë: E.5.6-Agjenda e Javes Orientuese; E.5.3-Rregullore e ZKMS)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe programin e studimit. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit (ZKMS) është përgjegjëse për krijimin e programit të mentorimit (neni 4 pika 3 Evidenca E.5.3-Rregullore e ZKMS). Në dokumentin Rregullore “Për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentit” neni 3 “Funksionet e zyrës” trajtohet ndërveprimi që realizon zyra me studentët.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (Tutoriati dhe Mentorimi) ka për mision të orientojë, inkurajojë dhe të mbështesë studentët pranë “Albanian University” për zhvillimin e tyre personal dhe profesional nëpërmjet aktivizimit në programe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Objektivi kryesor i kësaj zyre është të mbështesë studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe të shërbejë në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi. Gjatë vizitës me përfaqësues të kësaj njësie mësuam për orientimin që kjo njësi u jep studentëve për realizimin e praktikave apo informime në lidhje me mundësitë e punësimit të tyre. (Evidencë E.5.3-Rregullore e ZKMS)</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të</p>	<p>Rolin e njësisë për këshillimin e karrierës e luan Zyra e Karrierës dhe Alumni e cila zhvillon veprimtarinë e saj mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin, Rregulloren e Përgjithshme të Albanian University si dhe Rregulloren e saj (E.5.2-Rregullore e ZKA). Zyra e Këshillimit dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar, dhe ka një bazë të dhënash në lidhje me punësimin apo vazhdimin e mëtejshëm të studimeve të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Statutin (<i>neni 11 "Njësi të tjera në AU pranë Rektoratit"; neni 25 "Komisionet e përhershme"; 66 "Komisioni për vlerësimin Institucional" dhe neni 67 "Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë"</i>) dhe Rregulloren e Universitetit Privat "Albanian University" janë të përcaktuara strukturat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Struktura që realizon këtë proces në nivel institucional është <i>Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) (Evidencë E.6.2-Vendim Senati mbi krijimin e Komisioneve të Përhershme në rang Institucional E.6.1-VS për krijimin e Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë)</i> . Komisioni për vlerësimin institucional ngrihet pranë Rektoratit dhe përbëhet nga 5 anëtar të cilët zgjidhen nga Senati. Komisioni mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standardet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europian të Arsimit të Lartë (HEAL) është përgjegjës për ngritjen, funksionimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të brendshëm të cilësisë në AU. Komisioni kontrollon veprimtarinë e NJSBC-së. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë operon në bazë të Rregullores (Evidencë E.6.8-Rregullore e NJSBC). Standardet për sigurimin e cilësisë në AU janë në përputhje me Kodin e Cilësisë, hartuar nga ASCAL dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila ka për detyrë monitorimin dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë mësimore e kërkimore. Kjo zyrë realizon politikën, strategjitë dhe proceset për të garantuar cilësinë në Institucion. Në bazë të Rregullores së NJSBC neni 4 NJSBC planifikon dhe organizon vlerësimin e brendshëm të cilësisë për: a) Programeve të studimit dhe b) Vlerësimin të brendshëm të institucionit. NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e Albanian University. Institucioni me vendim Nr.55 datë 23/12/2021, të Senatit Akademik, ka miratuar " <i>Strategjinë tre vjeçare për sigurimin e cilësisë; 2022 – 2025</i> " për realizimin e objektivave të cilësisë (Evidencë: E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë). Institucioni angazhon dhe ekspertë të jashtëm pranë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	NJSBC-së (Evidencë: E.6.5.a-VR per Konsulentin Juridik; E.6.5.b-VR per Konsulent te zhvillimit te kurrikulave)		
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Albanian University përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Dokumenti ku bazohet NJSBC për punën në sigurimin e cilësisë është “Rregullore e NJSBC” i cili specifikon parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në institucion në përputhje me aktet rregullatore të AU. Institucioni i është nënshtruar akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit në mënyrë të vazhdueshme. NJSBC administron, organizon dhe përgatit sesione trajnimi duke ftuar ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin e Albanian University (Evidencë: E.3.1.b-Agjenda e Trajnimeve te personelit adm-21-22).		
Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Institucioni ka politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin e cilësisë. Struktura përgjegjëse NJSBC, programon punën në bazë të Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë, dhe aktivitetet e veprimit të përvitshëm. Rregullorea e NJSBC, në nenin 7, “Sigurimi i Cilësisë në Programet e Studimit” përcaktohet se NJSBC në bashkëpunim me Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti si dhe Zyrën e Zhvillimit të kurrikulave realizojnë sigurimin e cilësisë për programet e studimit. Neni 8 i E.6.8-Rregullores së NJSBC lidhet me “Sigurimin e cilësisë në mësimdhënie” duke përcaktuar metodat e vlerësimit dhe instrumentat që përdoren për këtë qëllim. Këto metoda përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> - Pyetorë me studentët që ndjekin programin e studimit. - Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit - Fokus-grupe - Intervista - Etj Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen dispozicion të strukturave drejtuese dhe njëjësive bazë.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Albanian University përcaktohen strukturat që hartojnë politika dhe procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në nivel institucional është Komisioni për Vlerësim Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) strukturat që realizojnë monitorimin dhe vlerësimin periodik mbi efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore-shkencore, të institucionit. Në nivel njëjësive bazë është Departamenti i cili ka programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme “Njësinë e Sigurimit të Cilësisë” (Evidencë: E.6.8-Rregullore e NJSBC (Neni 7; pika 3); E.6.3.b-VS Miratimi Anetareve te Sig Cilesise 21-22), koordinatoren e programit dhe stafin akademik.
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e	Institucioni ka një “Rregullore për mbarvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU” (Evidenca E.6.6). Nën kujdesin e Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Departamenti në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Cilësisë brenda tij angazhon strukturën akademike në rishikimin e syllabuseve (Evidencë: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022). Kjo procedurë është e përcaktuar në E.6.8-Rregulloren e NJSBC (Neni 7) . Gjithashtu në Rregulloren e NJSBC në nenet 7, 8 dhe 9 janë përcaktuar mekanizmat dhe proceset formale e të dokumentuara për monitorimin e programeve të studimeve të ciklit të parë.			
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Universiteti Privat “Albanian University” ka ndërtuar mekanizma monitorimi dhe vlerësimi periodik për programet e studimit që ofron. Këto mekanizma kanë në fokus monitorimin e procesit të mësimdhënies, aktivitetin kërkimor dhe zhvillimin e kapaciteteve akademike dhe ndihmës akademik. Në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2022-2025 (fq.3-5) janë të përcaktuara instrumentat e matjes së cilësisë si mëposhtë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Pyetësorët e studentëve 2. Fokus Grupe me studentët 3. Raporte vetvlerësimi nga pedagogët 4. Formulari i veprimtarisë kërkimore –shkencore të pedagogëve 5. Formulari i drejtuesit të departamentit për vlerësimin e pedagogëve 6. Raport vjetor i vetvlerësimit të programeve të studimit 7. Pyetësor drejtuar stafit akademik 8. Raportet semestrale dhe vjetore të njëjësive bazë dhe kryesore Institucioni dhe struktura përgjegjëse NJSBC përmes aktiviteteve me karakter monitorues nga Departamenti dhe njësia kryesore realizon vlerësimin në nivel institucional të të gjitha programeve të studimit. Në veprimtarinë e NJSBC-së dhe strukturave të tjera përgjegjëse përfshihen kontrole periodike të syllabuseve, përpunimi i të dhënave të pyetësorit online të studentëve, të fokus-grupeve mbi vlerësimin e mësimdhënies, procesit mësimor, infrastrukturës, etj E.6.8-Rregulloren e NJSBC (Neni 7, 8 dhe 9) . Gjithashtu dhe raportet e vetvlerësimit si nga stafi akademik dhe nga drejtuesi i departamentit janë instrumente të rëndësishme në këtë proces (Evidencë: E.3.2.d-Formulari i vlerësimit nga Drejtuesi i Departamentit).			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raportet e realizuara nga NJSBC-ja janë në dispozicion të strukturave drejtuese (Rektoratit) dhe të gjitha instancave përkatëse. Në varësi të analizës së të dhënave dhe instrumentave të përdorur bëhet dhe trajtimi i rezultateve në disa nivele brenda institucion (psh: Senat Akademik, Departament...etj) (Evidencë: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022).			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Në nivel departamenti realizohen dy raporte semestral dhe vjetore (Evidencë E.3.2.c-Raport Vjetor Departamenti dhe E.3.2.b-Raport Semestral Departamenti). Këto raporte analizojnë rezultatet e arritura për programet e studimit (ecuria e tyre, statusi, çështjet e akreditimit, rishikimi i kurrikulave etj), cilësinë e stafit akademik (rekrutimet, puna e pedagogëve e matur përmes raporteve të vetvlerësimit dhe puna e pedagogëve e matur përmes pyetësorëve të studentëve), të studentëve (analiza përqëndrohet në informimin e tyre, zbatimin e kalendarit akademik, aksesin në literaturë, vlerësimet, kontrollin e regjistrave). Pjesë e analizës së raportit janë dhe infrastruktura, financimi apo kërkimi shkencor etj. Gjithashtu analiza SWOT dhe evidentimi i pikave të forta dhe të dobta është një tjetër aspekt që trajtohet në këto raporte (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VL3

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe financiare të “Albanian University”. NJSBC-ja në bashkëpunim me instancat përkatëse realizon vlerësim periodik në nivel institucional tek të gjitha programet e studimit (Evidencë Minuta Bsc Shkenca Politike adminisitrative). Kjo strukturë nuk harton relacione specifike në bazë programi. Departamenti realizon analizë të përgjithshme për të gjitha programet e studimit që ofron.</p>		
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka miratuar disa dokumente si strategji apo rregullore ku janë të përcaktuara instrumentat e matjes së cilësisë për realizimin e procesit të vlerësimit (psh: Evidencë Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2022-2025; E.6.8-Rregulloren e NJSBC). Gjatë vizitës në institucion dhe takimin e realizuar me anëtarë të zyrës së NJSBC u trajtuan metodat dhe instrumentat që përdoren për realizimin e procesit të vlerësimit (Evidencë Minuta Bsc Shkenca Politike adminisitrative).</p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimin me anëtarë të zyrës së NJSBC na rezultojnë se institucioni përdor forma të ndërthurura për realizimin e vlerësimit dhe ruajtjes së cilësisë së programit të studimit. Realizimi i fokus-grupeve bëhet në bazë programi kun ë mënyrë rastësore formohet një grup studentësh prej 5-6 vetë dhe bëhen pyetje rreth programit për çdo aspekt (Evidencë Minuta Bsc Shkenca Politike administrative (fq. 11)). Për stafin akademik realizohen monitorime nga ana e eprorëve dhe për këtë ka një format standard ku përfshihen komponentë si organizimi dhe qartësia e leksionit; komunikimi me studentët etj. Në përfundim të procesit hartohet një raport vlerësimi mbi rezultatet e monitorimit. Pjesë e metodave të drejtpërdrejta të vlerësimit janë dhe nxjerrja e statistikave të kalueshmërisë së studentëve, nota mesatare, rishikimi i syllabuseve etj (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022). Format i vlerësimit të performancës akademike të studentëve bëhet nga një ndërthurje instrumentash si testim me shkrim, detyra kursi, aktivizimi etj (Evidencë E.4.5-Syllabuset e Lëndëve).</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni në kuadër të vlerësimit të realizimit garanton rolin e studentëve në procesin e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies, të mendimit të tyre mbi programet studimore, mbi etikën e komunikimit të pedagogëve etj. Format e aplikuar për këtë qëllim janë pyetësorët e formularët e administruar nga NJSBC dhe takimet periodike me studentët në formën e “fokus-grupeve”. Këto instrumenta analizohen dhe nëpërmjet tyre evidentohen problematikat e ndeshura në procese kyçe të veprimtarisë mësimore – kërkimore (të tilla si: shpërndarja e ngarkesës mësimore në nivel departamenti, kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, cilësia e mësimdhënies dhe çështje të vlerësimit të studentëve. Struktura përgjegjëse për realizimin e procesit të vlerësimit dhe hartimin e raporteve me gjetjet përkatëse në nivel institucional është NJSBC-ja. Në vitin 2021-2022 është realizuar një pyetësor me 24 pyetje drejtuar stafit akademik dhe administrativ mbi “Lumturinë në punë”. Rezultatet e këtij pyetësori janë sintetizuar në formën e një raporti (Evidencë E.6.7-Pergjigjet e Anketimit mbi Lumturinë në Punë).</p>		
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Shkalla e përmbushjes së standardit				X
-------------------------------------	--	--	--	---


Standardi VI.4
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentet themelore si Statut, Rregullore, Plan strategjik apo Strategji Universiteti ka parashikuar strukturat përgjegjëse për realizimin e procedurave të brendshme të cilësisë dhe garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar në këtë proces. Realizimi i instrumentave të matjes së cilësisë si pyetësorë, fokus-grupe, anketa, formularë apo dhe bashkëpunimi me ekspert të jashtëm janë elementë/mekanizma që sigurojnë përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; E.1.3-Rregullore e Përgjithshme e AU; E.1.2- Plani Strategjik Institucional; E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në dokumentet themelore të institucionit janë të përcaktuara përgjegjësitë dhe detyrat e njësive të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Më konkretisht, Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit Institucional dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me njësitë kryesore dhe departamentet dhe përfshirjen e studentëve janë hallkat që bashkëpunojnë për arritjen dhe ruajtjen e standardeve të cilësisë (Evidencë: E.6.8-Rregulloren e NJSBC E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë). Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë monitoron zbatueshmërinë e këtyre standardeve tek strukturat dhe funksionimi i stafit dhe institucionit në tërësi. Këto struktura nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit të veprimtarive akademike, kërkimore shkencore dhe administrative që ushtrohen në Albanian University duke patur në fokus përmirësimin e vazhdueshëm të punës së këtij universiteti. Mbështetur në dokumentacion vërtetohet se përmes urdhërave dhe vendime të organeve drejtuese të institucionit realizohet ndarja e detyrave tek njësitë dhe individët që përfshihen në organizimin dhe menaxhimin e veprimtarisë akademike, kërkimore shkencore etj. (Evidencë E.6.3.b (dhe a)-VS Miratimi Anetareve të Sig Cilesise 21-22; E.6.2-Vendim Senati mbi krijimin e Komisioneve të Përhershme në rang Institucional; E.3.5-Grupi i Sigurimit të Cilesise në Nivel Departamenti)</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në Planin Strategjik, cilësohet se institucioni dhe departamenti harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimit të ciklit të parë (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022). Institucioni garanton përfshirjen e anëtarëve të njësive bazë dhe kryesore në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në Departamentin e Shkencave Juridike dhe Politiko-Administrative ka dy anëtarë që janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë i cili quhet grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti (Evidencë E.3.5-Grupi i Sigurimit të Cilesise në Nivel Departamenti; E.6.4-Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë</p>	<p>Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, përfshirja e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit kryet në përputhje me Kodin e Etikës dhe përpiqet të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe të drejtave të studentëve. Në procesin e vlerësimit të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	brendshëm të cilësisë respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj pabarazie kundrejt stafit dhe studentëve. Realizimi i pyetësorëve të vlerësimit të stafit akademik nga ana e studentëve bëhet duke ruajtur anonimatën e studentit.		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga RVB nuk është shumë e qartë nëse ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm në mënyrë aktive që kanë lidhje me programin e studimit dhe që marrin pjesë në vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Nga shqyrtimi i dokumentave rezulton se institucioni ka angazhuar ekspert/konsulent për zhvillimin e kurrikulave apo konsulent juridik (Evidencë E.6.5.b-VR per Konsulent te zhvillimit te kurrikulave; E.6.5.a-VR per Konsulentin Juridik). Në RVB në lidhje me këtë kriter trajtohet rëndësia që i është dhënë adresimit të rekomandimeve të ekspertëve në kuadër të procesit të akreditimit për këtë program studimi duke përmirësuar kurrikulën e këtij program studimi (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022). <i>GVJ konstaton mungesë të dokumentacionit mbështetës lidhur me rolin që ekspertiza e jashtme duhet të japë në vlerësimin e cilësisë për programin e studimit bachelor në "Shkenca Politiko-Administrative.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të një kalendarit akademik (plani i veprimtarisë) (Evidencë Minuta Bsc Shkenca Politike administrative). Rregullorja e NJSBC për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2022 – 2025 janë dokumente të cilët përcaktojnë politikat dhe organizimin e veprimtarisë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë. Institucioni në përfundim të çdo viti akademik dërgon pranë MAS raportin vjetor të veprimtarisë mësimore e kërkimore-shkencore të institucionit. Ky raport gjendet në faqen zyrtare të Albanian University. (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022).
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Vlerësimi kryhet në nivel institucional, dhe rezultatet e tij iu bëhen me dije strukturave drejtuese. Struktura drejtuese i përcjell rezultatet në njësinë bazë dhe ato element që lidhen me këtë njësi. Në departament trajtohet me stafet akademike ato elementë të vlerësimit që lidhen ngushtë me veprimtarinë e tyre. Raportet e NJSBC-së janë transparente dhe publikohen në faqen e web-it të "Albanian University". <i>GVJ hyri në këto site dhe konfirmoi publikimin e tyre.</i> (Evidence linku: https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/Raport-vjetor-v.a-2020-2021-pdf.pdf). Në nivel departamenti përgatiten raporte vjetore ku analizohet puna e tij (Evidencë E.3.2.c-Raport Vjetor Departamenti).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Institucioni realizon në vijueshmëri procesin e përpilimit të rezultateve dhe masave që duhet të ndërmerren si rezultat i raportit. Sipas RVB-së të dhënat e përfituara nga raporti i vetvlerësimit të programit të studimit dhe raporti vjetor i departamenti kanë rëndësi jo vetëm për analizën e situatës por dhe për masat e mara nga planveprimi i një viti të mëpërparshëm dhe projekcioni për vitin e ardhshëm. (Evidencë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm 2022).

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Përpjekjet për të reflektuar gjetjet e raportit sikundër dhe monitorimin janë në nivel institucional. Përmes kontrollit të kryqëzuar, strukturat dhe aktorë të brendshëm të “Albanian University” reflektojnë mbi rezultatet e raportit dhe realizojnë masa që lidhen me programet e studimit për ta përmirësuar më tej.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Rëndësia që ka për institucionin për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë është e pranishme në çdo dokument themelor ku bazohet ndërtimi i strukturave dhe puna e tyre në institucion. Në fillim të vitit akademik, studentët orientohen mbi funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Gjithashtu institucioni organizon trajnime për rritje kapacitetesh për stafin e tij. Realizimi i vlerësimit të përvitshëm nga ana e NJSBC-së përmes planit të punës mundëson angazhimin e strukturave akademike dhe studentët në proces. Aksesi në dokumentat ku bazohet kjo veprimtari është e mundur si për stafin akademik, administrativ dhe studentët në nivel institucional. (Evidencë: E.1.4- Statuti i Albanian University; E.1.3-Rregullore e Pergjithshme e AU; E.1.2- Plani Strategjik Institucional; E.5.5-Manuali i Studentit; E.3.1. (a) b-Agjenda e Trajnimeve te personelit adm-21-22)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Shkenca Politico-Administrative.” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Albanian University”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Institucioni mundëson infrastrukturë fizike, didaktike, logjistike që garanton suksesin e aktivitetit mësimor.
2. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të metodave të mësimdhënies duke i bërë ata pjesë të diskutimeve në mbledhjet e departamentit duke dhënë opinionet e tyre për cilësinë e mësimdhënies.
3. Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është i mbështetur në modelet bashkëkohore të programeve të ngjashme të ofruara nga IAL të tjera, brenda dhe jashtë vendit.
4. Staf i akademik i angazhuar në programin e studimit ka eksperiencën dhe kualifikimet e duhura, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit.
5. Përdorimi i metodave interaktive dhe përfshirja e studentëve në këtë proces, evidentohet si një pikë e fortë e këtij programi studimi.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Pika të dobëta:

1. Mungon një studim cilësor dhe i mirëfilltë për tregun e punës në fushën e shkencave politike me ndërthurjen që ka programi në fushën administrative. Departamenti ka realizuar një studim (Evidenca E.1.7-Analiza e tregut të punës) që synon të analizojë tregun e punës por ky dokument është i pamjaftueshëm për t'u konsideruar studim i mirëfilltë.
2. regut pasi mungojnë të dhënat statistikore dhe duhen hulumtime më serioze.
3. Numri i ulët i marrëveshjeve të bashkëpunimit për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve.
4. Niveli relativisht i ulët i përfshirjes së stafit akademik në projekte kërkimore shkencore dhe bashkëpunimit me kërkues shkencor vendas apo të huaj.
5. Mungesa e një sistemi elektronik të menaxhimit të të dhënave të studentëve dhe personelit.

Rekomandime:

1. Institucioni të mbështesë dhe të nxisë fushatat promovuese për këtë program studimi në mënyrë që të tërheq sa më shumë aplikues. Panvarsisht se numër i vogël i studentëve që studiojnë në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politiko-Administrative" lidhet me disa faktor, fushatat promovuese mund të kontribuojnë në njohjen më të mirë të risive dhe avantazheve që ka ky program nga maturantët.
2. Sugjerohet që departamenti që ofron këtë program studimi të ndërmarrë një studim cilësor dhe sasior të tregut, të detajuar ku të jepen të gjitha analizat, statistikat, rezultatet dhe alternativat mbi bazën e së cilës do të mund të këtë vijueshmëri dhe aftësi konkurruese si program studimi.
3. Të rritet financimi nga institucioni për pasurimin e bibliotekës me botime të viteve të fundit nga autorë vendas dhe të huaj në fushën e shkencave politike dhe administrative.
4. Institucioni duhet të punojë për shtimin e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, sikurse dhe përfshirjen e stafit akademik në projekte kërkimore shkencore.
5. Institucioni duhet të hartojë dhe implementojë një sistem vlerësimi me pikë të kandidatave, gjatë procesit të rekrutimit të personelit të ri.
6. Me qëllim dixhitalizimin e të dhënave dhe aksesin efikas në informacion, institucioni duhet të marrë masa për vendosjen e një Sistemi Menaxhimi elektronik të të dhënave të studentëve por edhe personelit akademik dhe administrativ.



Conclusions of the Evaluation of the study program of the first cycle Bachelor "Political-Administrative Science." of the Institution of Higher Education "Albanian University"

Strengths and Affirmations:


1. The institution provides physical, didactic, logistical infrastructure that guarantees the success of the educational activity.
2. The institution guarantees the involvement of students in the periodic evaluation of teaching methods by making them part of the discussions at departmental meetings and giving their opinions on the quality of teaching.
3. The organization and content of the study program is based on contemporary models of similar programs offered by other HEIs, inside and outside the country.
4. The academic staff engaged in the study program has the appropriate experience and qualifications, in order to fulfill the objectives of the study program.
5. The use of interactive methods and the involvement of students in this process is evidenced as a strong point of this study program.

Weak points:

1. There is a lack of a qualitative and genuine study of the labor market in the field of political sciences with the overlap that the program has in the administrative field. The department has carried out a study (Evidence E.1.7-Analysis of the labor market) that aims to analyze the labor market, but this document is insufficient to be considered a genuine market study as statistical data is missing and more serious research is needed.
2. The low number of cooperation agreements for the mobility of academic staff and students.
3. The relatively low level of involvement of academic staff in scientific research projects and cooperation with local or foreign scientific researchers.
4. Lack of an electronic system for managing student and staff data.

Recommendations:

1. The institution should support and encourage promotional campaigns for this study program in order to attract as many applicants as possible. Regardless of the fact that the small number of students studying in the Bachelor's program in "Political-Administrative Science" is related to several factors, promotional campaigns can contribute to a better recognition of the innovations and advantages of this program by graduates.
2. It is suggested that the department that offers this study program undertake a qualitative and quantitative study of the market, detailed where all analyses, statistics, results and alternatives are given on the basis of which it will be able to this continuity and competitiveness as a program the study.
3. To increase funding from the institution for enriching the library with publications of recent years by local and foreign authors in the field of political and administrative sciences.



4. The institution should work on increasing the number of cooperation agreements for the mobility of academic staff and students, as well as the involvement of academic staff in scientific research projects.
5. The institution must design and implement a scoring system for candidacies, during the recruitment process of new personnel.
6. In order to digitize data and provide efficient access to information, the institution must take measures to establish an electronic data management system for students and academic and administrative personnel.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X